

KOSOVA

RAPORTI I VITIT 2021 PËR TË DREJTAT E NJERIUT NË KOSOVË

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Kosova është demokraci parlamentare. Kushtetuta dhe ligjet parashikojnë një parlament të zgjedhur njëdhomësh (Kuvendin), i cili më pas e zgjedh një kryetar dhe e miraton kryeministrin të cilin e zgjedh kryetari në konsultim me patinë udhëheqëse. Zgjedhjet e jashtëzakonshme parlamentare u mbajtën në shkurt pasi Gjykata Kushtetuese vendosi që themelimi i qeverisë së udhëhequr nga kryeministri i atëhershëm Avdullah Hoti ishte jolegjitim sepse vota vendimtare ishte dhënë nga një deputet të cilit i ishte hequr mandati. Procesi zgjedhor u konsiderua kryesisht i lirë dhe i drejtë nga vëzhguesit e pavarur. Kuvendi u themelua në mars dhe e zgjodhi një qeveri të re me Albin Kurtin si Kryeministër. Në prill, Kuvendi e zgjodhi Vjosa Osmanin për Presidente.

Forcat e sigurisë përfshijnë Policinë e Kosovës dhe Forcën e Sigurisë së Kosovës, të cilat i raportojnë Ministrisë së Punëve të Brendshme, respektivisht Ministrisë së Mbrojtjes. Autoritetet civile mbajtën kontroll efikas të forcave të sigurisë. Pati raporte të besueshme se pjesëtarët e forcave të sigurisë kryen disa abuzime, përfshirë përdorimin e dyshuar të forcës së tepruar dhe keqtrajtimin e të burgosurve nga policia. Rastet që kanë të bëjnë me Policinë e Kosovës janë raportuar në Inspektoratin Policor të Kosovës, autoriteti hetues për veprat penale të kryera nga policët dhe për inspektimin e proceseve policore. Qeveria vazhdoi procesin e kalimit gradual dhe transparent të Forcës së Sigurisë së Kosovës në një forcë shumetnike të mbrojtjes territoriale, në përputhje me planin 10-vjeçar, i cili filloi në vitin 2019. Policia Kufitare, një departament i Policisë së Kosovës, është përgjegjëse për sigurinë në kufi. Policia ruan sigurinë e brendshme, me Misionin e Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në vend, si reagues i dytë. Forca e Kosovës, e udhëhequr nga NATO, një forcë paqeruajtëse ndërkombëtare, është reaguesi i tretë. Forca e NATO-s në Kosovë është përgjegjëse për ofrimin e një mjedisi të qetë e të sigurt dhe për sigurimin e lirisë së lëvizjes për të gjithë qytetarët. Që nga korriku, misioni i Forcës së Kosovës kishte afërsisht 3.800 ushtarë nga 28 vende.

Në çështje të rëndësishme të të drejtave të njeriut përfshiheshin raporte të besueshme për: kufizime serioze mbi lirinë e shprehjes dhe mediat, përfshirë dhunën ose kërcënimet me dhunë ndaj gazetarëve; korrupsionin serioz në qeveri dhe mosndëshkimin; dhe krimet që përfshinin dhunë ose kërcënime për dhunë që synonin pakicat etnike ose komunitetet e tjera të marginalizuara.

Qeveria ndërmori masa për t'i identifikuar, hetuar, ndjekur penalisht dhe ndëshkuar zyrtarët që kishin kryer abuzime të të drejtave të njeriut, por nganjëherë i mungonte konsistenca. Shumë veta në qeveri, opozitë, shoqëri civile dhe media raportuan raste të zyrtarëve të lartë të përfshirë në korrupsion ose që vepronin pa u ndëshkuar. Qeveria nganjëherë i suspendonte, i largonte shkelësit nga detyra, ose i transferonte të akuzuarit, dhe sektori i drejtësisë nganjëherë ndërmerre hapa për t'i ndjekur penalisht dhe ndëshkuar ata zyrtarë që kishin kryer abuzime, shkelje dhe krime. Megjithatë, shumë zyrtarë të korruptuar vazhduan të mbanin poste në sektorin publik.

KOSOVA

Seksioni 1. Respektimi i integritetit të personit

a. Privimi arbitrar i jetës dhe vrasjet e paligjshme apo të motivuara politike

Nuk pati raportime që Qeveria apo agjentët e saj kryen vrasje arbitrare apo të paligjshme. Inspektorati Policor i Kosovës (IPK) është përgjegjës për hetimin e akuzave për vrasje arbitrare ose të paligjshme nga Policia e Kosovës; megjithatë, Policia e Kosovës është përgjegjëse për hetimin e pretendimeve kundër zyrtarëve qeveritarë apo agjentëve të saj, dhe Prokuroria e Shtetit është përgjegjëse për ndjekjen penale të rasteve të tilla. Misioni i BE-së për Sundim të Ligjit (EULEX) monitoroi raste dhe gjykime të përzgjedhura penale dhe civile në sistemin gjyqësor, e këshilloi Shërbimin Korrektues dhe ofroi mbështetje logjistike për Dhomat e Specializuara të Kosovës në Hagë.

Dhomat e Specializuara të Kosovës dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar të Kosovës (PSK) janë institucione të Kosovës, të krijuara sipas ligjit të Kosovës dhe me gjykatës, prokurorë dhe zyrtarë ndërkombëtarë, për t'i hetuar dhe ndjekur penalisht krimet kundër njerëzimit, krimet e luftës ose krimet e tjera të rënda të kryera ndërmjet viteve 1998 dhe 2000. PSK-ja dhe paraardhësi i saj, Task Forca Speciale Hetuese e BE-së, u krijuan pas publikimit të raportit të Këshillit të Evropës në vitin 2011, *“Trajtimi çnjerëzor i personave dhe trafikimi i paligjshëm i organeve njerëzore në Kosovë”*, i cili pretendonte se udhëheqës individualë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës kishin kryer akte që do mund të përbënin krime lufte në Kosovë ndërmjet viteve 1999-2000. Në nëntor 2020, Dhomat e Specializuara të Kosovës konfirmuan publikisht një aktakuzë të ngritur nga ZPS-ja që akuzonte Presidentin e atëhershëm Hashim Thaçi, ish-kryetarin e Kuvendit Kadri Veseli dhe dy të tjerë për krime kundër njerëzimit dhe krime lufte. Në tetor, Dhomat e Specializuara e refuzuan kërkesën e të pandehurve për lirim me kusht nga paraburgimi duke përmendur shqetësimin se të pandehurit do të përpiqeshin të arratiseshin dhe rrezikun e lartë që të pandehurit do të mund t'i vazhdonin përpjekjet për t'i frikësuar ose për të ndërhyrë në dëshmitarë ose anëtarë të familjeve të tyre. Në fund të vitit, gjykimet kundër të pandehurve nuk kishin filluar ende. Kishte edhe tri raste të tjera në pritje kundër ish-pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Që nga shtatori, Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës (PSRK) kishte nën hetim zyrtar 12 raste të krimeve të luftës. Gjatë vitit, PSRK-ja lëshoi një aktvendim për fillimin e një hetimi. Një rast i profilit të lartë i krimeve të luftës, i njohur si “Drenica I”, u dërgua për rigjykim në vitin 2017, por u vonua disa herë. Asnjë seancë dëgjimore nuk ishte mbajtur që nga dhjetori.

Në korrik, Gjykata Themelore e Prishtinës e dënoi ish-policin serb Zoran Vukotiq me tri vjet e gjysmë burg shtesë për dhunimin e një gruaje shtatzënë, shqiptare e Kosovës, gjatë kohës së luftës dhe për pjesëmarrje në dëbimin e civilëve shqiptarë të Kosovës nga qyteti i Vushtrrisë. në vitin 1999. Që nga viti 2019, Vukotiqi ka qenë duke e vuajtur një dënim prej 6.5 vjetësh për krime të luftës: ndalim dhe torturim i paligjshëm i të burgosurve shqiptarë të Kosovës në rajonin e Mitrovicës. Dënimi shtesë shënoi herën e parë që një gjykatë e Kosovës e dënoi një të pandehur për dhunim në lidhje me luftën

Në mars, Gjykata Themelore e Prishtinës e dënoi serbin nga Kosova Zllatan Kërstiq dhe shqiptarin nga Kosova Destan Shabani, të dy ish-oficerë të policisë serbe, me 14.5 vjet,

Raportet e Shtetit mbi Praktikën e të Drejtave të Njeriut për vitin 2021
Departamenti i Shtetit i Shteteve të Bashkuara • Zyra për Demokraci, të Drejta të Njeriut dhe Punë

KOSOVA

përkatësisht shtatë vjet burg, për krime lufte kundër civilëve shqiptarë të Kosovës. në vitin 1999. Aktakuza e ngarkonte Kërstiqin me përfshirje të drejtpërdrejtë në një sulm kundër civilëve në vitin 1999 në Ferizaj, përfshirë dëbimin e një familjeje vendase shqiptare nga Kosova, torturimin, shkatërrimin e pronës dhe marrjen peng të katër civilëve dhe më pas vrasjen e tyre. Gjykata e dënoi Shabanin për urdhërimin e varrimit të katër viktimave në vitin 1999 pa dinjitet dhe në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare humanitare.

Në shkurt, Gjykata Themelore e Prishtinës e dënoi serbin e Kosovës Zoran Gjokiq me 12 vjet burg për krime lufte kundër shqiptarëve të Kosovës të kryera ndërmjet marsit dhe prillit 1999. Sipas aktakuzës, Gjokiq, si anëtar i një grupi paramilitar serb, mori pjesë në sulmet dhe shpërnguljet e dhunshme të shqiptarëve të Kosovës në Pejë.

b. Zhdukja

Nuk pati raportime për zhdukje nga apo në emër të autoriteteve qeveritare.

Që nga shtatori, Komisioni Qeveritar për Persona të Zhdukur kishte të regjistruar 1.632 persona të zhdukur, të cilët u zhdukën gjatë konfliktit të vitit 1998-99 dhe dhuna politike që pasoi. Sipas ligjit, databaza qeveritare për persona të zhdukur nuk përfshin prejardhjen etnike të personave të zhdukur, përveç nëse vullnetarisht raportohet nga familja e tyre. Komisioni vlerësoi që rreth 70 për qind ishin shqiptarë dhe 30 për qind ishin serbë, romë, ashkalinj, egjiptianë, boshnjakë, goranë, malazezë dhe të tjerë.

c. Torturimi dhe trajtimet apo ndëshkimet e tjera të egra, çnjerëzore apo poshtëruese

Kushtetuta dhe ligjet ndalojnë praktika të tilla, por ligjet nuk janë zbatuar në mënyrë konsistente dhe ka pasur pretendime të vazhdueshme që disa të arrestuar keqtrajtoheshin nga policia dhe, në një shkallë më të vogël, nga personeli i shërbimit korrektues.

Që nga korriku, Institucioni i Avokatit të Popullit raportoi se kishte pranuar 12 ankesa të regjistruara: shtatë kundër policisë për keqtrajtim dhe pesë kundër shërbimit korrektues. Në ankesat kundër shërbimit korrektues përfshiheshin: një për keqtrajtim, tri për kujdes shëndetësor dhe një për kushte çnjerëzore të jetesës. Përveç kësaj, katër policë të Njësisë Speciale të Policisë u arrestuan në qershor për përdorim të tepruar të forcës në vitin 2019.

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës, që vepron nën Institucionin e Avokatit të Popullit, e vazhdoi punën normale pas pezullimit të aktiviteteve në vitin 2020 për shkak të masave kufizuese për COVID-19. Mekanizmi Kombëtar për Parandalim kreu 31 vizita në të gjitha vendet e privimit të lirisë, si burgje dhe qendra të paraburgimit, objekte psikiatrike, shtëpi të kujdesit social, qendra të pritjes së azilit, stacione policore dhe në Qendrën e Ndalimit Administrativ. Ai raportoi se nuk kishte zbuluar asnjë provë të besueshme të torturës nga forcat e sigurisë gjatë vitit.

Qendra Kosovare për Rehabilitimin e Viktimave të Torturës raportoi se keqtrajtimi i të burgosurve nga policia vazhdoi të ishte problem. Në janar, tre policë u arrestuan në Prishtinë pasi një hetim i IPK-së zbuloi video të policëve duke përdorur forcë të tepërt gjatë një arrestimi.

Raportet e Shtetit mbi Praktikën e të Drejtave të Njeriut për vitin 2021
Departamenti i Shtetit i Shteteve të Bashkuara • Zyra për Demokraci, të Drejta të Njeriut dhe Punë

KOSOVA

Në gusht, IPK-ja e arrestoi një polic në Ferizaj për përdorim të tepruar të forcës dhe përndalimin e një personi për më shumë se 48 orë.

Më 5 korrik, Gjykata Themelore e Gjilanit e dënoi një polic me gjashtë vjet burg për sulm seksual ndaj një femre të mitur me aftësi të kufizuara intelektuale.

Qeveria ndonjëherë e hetonte abuzimin, ndonëse mekanizmat për ta bërë këtë nuk ishin gjithmonë efektivë ose u nënshtroheshin ndërhyrjeve politike. Forcat e sigurisë nuk siguronin respektim të urdhrave të gjykatës kur zyrtarët lokalë nuk i zbatonin ato. Edhe pse disa policë u arrestuan nën akuzat për korrupsion gjatë vitit, mosndëshkimi mbeti problem.

IPK-ja është përgjegjëse për shqyrtimin dhe hetimin e ankesave për veprimet kriminale të policëve, si dhe për inspektimin e proceseve policore. Që nga nëntori, IPK-ja kishte pranuar 1.862 ankesa, 617 prej të cilave janë dërguar për hetim penal. Ankesat ishin kryesisht për keqtrajtim gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare, keqpërdorim të detyrës zyrtare, lëndim trupor, kanosje dhe dhunë në familje. IPK-ja raportoi se 158 policë ishin nën hetim, 78 ishin suspenduar dhe 31 ishin arrestuar. Inspektorati i përcolli 91 ankesa për ndjekje penale; pjesa tjetër e rasteve mbeti nën hetim.

Kushtet në burgje dhe qendra të ndalimit

Kushtet në burgje dhe qendra të ndalimit i plotësonin disa standarde ndërkombëtare, por pati probleme në burgje, posaçërisht dhuna ndërmjet të burgosurve, korrupsioni, ekspozimi ndaj pikëpamjeve radikale fetare apo politike, kujdesi mjekësor nën standarde dhe trajtimi joadekuat i të burgosurve me aftësi të kufizuara mendore.

Kushtet fizike: Sipas Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, kushtet fizike në qendrën e paraburgimit në Pejë nuk i plotësonin standardet ndërkombëtare për shkak të ventilimit joadekuat dhe mungesës së dritës natyrore në qeli. Të meta të ngjashme kishte edhe në qendrën e paraburgimit në Prizren dhe në burgun e Dubravës. Mekanizmi Kombëtar për Parandalim ka vërejtur një rënie të ndjeshme të numrit të të burgosurve, posaçërisht në burgun e Dubravës.

Qendra për Rehabilitimin e Viktimave të Torturës raportoi se autoritetet ofruan mbrojtje adekuate si për të burgosurit, ashtu edhe për zyrtarët korrektues. Zyrtarët e Qendrës Rehabilituese morën ankesa nga të burgosurit që pretendonin ngacmim verbal, dhunë ndërmjet të burgosurve dhe disa raste të keqtrajtimit fizik nga zyrtarët korrektues, kryesisht në Burgun e Dubravës, në Burgun e Sigurisë së Lartë në komunën e Podujevës, dhe në njësinë për të mitur në qendrën korrektuese në Lipjan. Qendra për Rehabilitim vërejt raste kur të burgosurit i shantazhonin dhe ngacmonin të burgosurit e tjerë në Burgun e Dubravës dhe në Burgun e Sigurisë së Lartë në Podujevë. Ajo raportoi se të burgosurit dhe të paraburgosurit kishin vështirësi në qasje në kujdesin mjekësor. Pati pohime për korrupsion dhe përdorim të transferimeve ndërmjet qendrave të paraburgimit si masa disiplinore. Qendra për Rehabilitim raportoi se të dënuarit herë pas here e lëndonin veten për ta tërhequr vëmendjen ndaj nevojave të tyre, përfshirë kujdesin mjekësor, transferimet ose privilegjet. Zyrtarët e Qendrës për

KOSOVA

Rehabilitim raportuan për raste të pretenduara të korrupsionit dhe nepotizmit, përfshirë nga personeli korrektues dhe shëndetësor, posaçërisht në qendrën korrektuese në Dubravë.

Që nga korriku, Mekanizmi Kombëtar për Parandalim raportoi se i kishte pranuar 10 raporte mjekësore nga autoritetet shëndetësore të burgjeve për lëndim të të burgosurve për shkak të dhunës ndërmjet të burgosurve dhe pesë raste të të burgosurve që pohonin të ishin lënduar nga zyrtarët korrektues. Mekanizmi Kombëtar për Parandalim i kontrolloi dosjet mjekësore të dërguara nga autoritetet, por nuk i vizitoi apo intervistoi, qoftë personalisht apo në mënyrë virtuale, të burgosurit e përfshirë në incidentet e supozuara, për shkak të kufizimeve për COVID-19.

Mekanizmi Kombëtar për Parandalim theksoi mungesën e aktiviteteve të strukturuar terapeutike dhe rehabilituese për pacientë në Spitalin e Burgut të Dubravës, me trajtim që konsiston kryesisht në farmakoterapi. Për shkak të mungesës së hapësirës, të burgosurit me çrregullime mendore vendoseshin me popullatën e përgjithshme të burgjeve.

Pas dorëzimit të një raporti mjekoligjor zviceran tek autoritetet në fund të vitit 2019, Kryeprokurori i Shtetit e rihapi hetimin për vdekjen në burg në vitin 2016 të aktivistit të partisë Vetëvendosje, Astrit Dehari, dhe ia caktoi çështjen Prokurorisë Speciale të Kosovës. Dehari ishte arrestuar nën dyshimin për përfshirje në një sulm ndaj parlamentit. Autoritetet hetuan nëse Dehari bëri vetëvrasje, por anëtarët e familjes së tij dhe përfaqësuesit e partisë Vetëvendosje pohuan që ai u vra për shkak të aktivizmit të tij politik. Qeveria kërkoi ndihmën zvicerane në vitin 2018; raporti zviceran i vitit 2019 theksoi se analiza mjekoligjore nuk mund të përjashtonte shkaqe të tjera të mundshme të vdekjes dhe rekomandoi hetime të mëtejme. Hetimi i kësaj çështjeje ishte duke vazhduar që nga dhjetori.

Për shkak të trajnimit të dobët dhe stafit të pamjaftueshëm, autoritetet nuk i kontrollonin gjithmonë objektet ose të burgosurit. Kishte mungesë të stafit të trajnuar për të ndihmuar me programet për trajtimin e të varurve nga droga. Nuk kishte asnjë testim të varësisë nga droga brenda shërbimit korrektues dhe sistemi i klasifikimit të të burgosurve me çështje që lidhen me varësinë nga droga nuk ishte plotësisht funksional. Qendra për Rehabilitimin e Viktimave të Torturës raportoi se droga, kryesisht marihuanë, kontrabandohej rregullisht në këto objekte, përkundër ndalimit të vizitave personale për të burgosurit për shkak të pandemisë COVID-19.

Qendra për Rehabilitim dokumentoi vonesa dhe gabime në ofrimin e kujdesit mjekësor për të burgosurit, si dhe mungesën e trajtimit të specializuar jashtë institucioneve korrektuese, posaçërisht në Burgun e Dubravës. Në shumë raste, këto kushte i detyruan të burgosurit t'i blinin barërat e nevojshme nga burimet private. Qendra për Rehabilitim vërejtë të meta në sistemin e kujdesit shëndetësor në Burgun e Dubravës dhe raportoi për numër të pamjaftueshëm të profesionistëve të shëndetit mendor. Ministria e Shëndetësisë është përgjegjëse për sigurimin e kujdesit mjekësor dhe të personelit shëndetësor në qendrat korrektuese.

Qendra për Rehabilitimin e Viktimave të Torturës raportoi se Qendra Korrektuese për të Mitur në Lipjan i strehonte të burgosurit e rritur, ndonëse në një ndërtesë të veçantë, për t'i angazhuar në punë. Qendra për Rehabilitim raportoi se vendosja e të dënuarve të rritur në një institucion për të mitur është e ndaluar me ligj.

KOSOVA

Objektet dhe trajtimi për të burgosur me aftësi të kufizuara mbetën nën standarde. Instituti i Psikiatrisë Forenzike të Kosovës për trajtim dhe strehim për të paraburgosur me aftësi të kufizuara mendore kishte kapacitet për vetëm 24 pacientë. Personat e tjerë të paraburgosur me çrregullime mendore vendoseshin në qelitë e burgut me të burgosur të tjerë. Ndërsa të paraburgosurit mbaheshin ndaras nga të burgosurit e dënuar, avokatët e personave me aftësi të kufizuara e fajësonin qeverinë që rregullisht i vendoste të paraburgosurit me aftësi të kufizuara mendore bashkë me të paraburgosurit e tjerë. Ligji kërkon që kriminelët e dënuar, me probleme të dokumentuara të shëndetit mendor, të mbahen në objekte të dedikuara për kujdes të shëndetit mendor, por këta të burgosur shpesh vendoseshin në burgje standarde për shkak të mbingarkesës në institucionet e shëndetit mendor. Përveç terapisë me barëra dhe konsultime ve të rregullta me psikiatër, të burgosurve me probleme të shëndetit mendor nuk u sigurohej ndonjë veprimtari profesionale apo terapeutike.

Administrata: Autoritetet nuk zhvillonin gjithmonë hetime të duhura për keqtrajtim. Qendra për Rehabilitimin e Viktimave të Torturës theksoi se mekanizmi i brendshëm për ankesa (për dallim nga Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës), i paraparë me ligj, nuk funksiononte në mënyrë efikase; zyrtarët u përgjigjeshin shumë ngadalë ankesave. Përveç kësaj, të burgosurit shpesh nuk i raportnin abuzimet për shkak të mungesës së konfidencialitetit dhe frikës nga hakmarrja. Megjithatë, Qendra për Rehabilitim theksoi se autoritetet nuk u ofronin rregullisht të burgosurve vendime me shkrim me të cilat arsyetohej izolimi në vetmi dhe informata për afatet e ankesave. Qendra për Rehabilitim theksoi se drejtori i përgjithshëm i Shërbimit Korrektues nuk i përgjigjej menjëherë kërkesës së Qendrës për informata lidhur me kërkesat e të burgosurve për transferim.

Monitorimi i pavarur: Ndonëse të gjitha vizitat u penguan për shkak të rrethanave të COVID-19, Qeveria u lejoi vizita vëzhguesve të pavarur të të drejtave të njeriut. Vetëm Institucioni i Avokatit të Popullit dhe EULEX-i kishin qasje të pakufizuar në institucionet korrektuese gjatë gjithë vitit. Qendra për Rehabilitimin e Viktimave të Torturës dhe Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut duhej të njoftonin 24 orë më parë për vizitat e planifikuara.

Përmirësimet: Qendra për Rehabilitimin e Viktimave të Torturës raportoi për përmirësime në kushtet e strehimit në Burgun e Dubravës, në Burgun e Sigurisë së Lartë në Prishtinë dhe në qendrën korrektuese në Prishtinë. Qendra për Rehabilitim theksoi se Departamenti Shëndetësor i Burgjeve ka punësuar personel shtesë gjatë vitit. Zyrtarët e Qendrës për Rehabilitim gjithashtu theksuan se disa burgje morën shtretër dhe dyshekë të rinj, duke zgjidhur një problem të vjetër.

Gjatë inspektimit të stacioneve policore, Mekanizmi Kombëtar për Parandalim theksoi për një përmirësim në kontrollin mjekësor, me një numër në rritje të stacioneve që ofronin kontrolle mjekësore për të arrestuarit me rastin e hyrjes dhe të daljes nga paraburgimi.

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës theksoi për një numër gjithnjë e më të madh të mundësive për punë, arsimim, trajnim dhe aktivitete rekreative në Burgun e Dubravës, në Qendrën Korrektuese për të Mitur, në Qendrën Korrektuese për Gra dhe në Qendrën Edukative Korrektuese në Lipjan.

d. Arrestimi ose ndalimi arbitrar

Kushtetuta dhe ligji ndalojnë arrestimin dhe ndalimin arbitrar dhe parashikojnë të drejtën e çdo personi për ta kundërshtuar ligjshmërinë e arrestimit ose ndalimit të tij/saj në gjykatë. Qeveria, EULEX-i dhe Forca e Kosovës (KFOR), e udhëhequr nga NATO-ja, në përgjithësi i respektuan këto ndalesa. Personeli i EULEX-it dhe i KFOR-it nuk i nënshtrohej sistemit ligjor të vendit, por masave disiplinore të misionit dhe të vendeve të tyre përkatëse.

Procedurat e arrestimit dhe trajtimi i të ndaluarve

Sipas ligjit, përveç kur krimi është në zhvillim e sipër, policia mund të arrestojë të dyshuar vetëm me urdhra të bazuar në prova dhe të lëshuar nga një gjykatës ose prokuror. Brenda gjashtë orëve pas arrestimit, prokurorët duhet t'ia lëshojnë personit të arrestuar një deklaratë me shkrim ku përshkruhen vepra e dyshuar dhe baza ligjore për akuza. Autoritetet duhet t'i sjellin të arrestuarit para gjykatësit brenda 48 orëve dhe duhet t'u sigurojnë të ndaluarve qasje të menjëhershme në avokatin të cilin e zgjedhin apo në avokatin e siguruar nga shteti. Ekziston edhe sistemi i dorëzarisë, por ai rrallë përdoret nga gjykatat. Ato shpesh i lironin të ndaluarit pa dorëzani, në pritje të gjykimit.

Të dyshuarit kanë të drejtë të refuzojnë t'u përgjigjen pyetjeve në të gjitha fazat e hetimit, përveç pyetjeve për identitetin e tyre. Të dyshuarit kanë të drejtë për ndihmë falas të avokatit dhe të përkthyesit, dhe për trajtim mjekësor e psikologjik. Të dyshuarit mund ta njoftojnë një anëtarë të familjes për arrestimin e tyre dhe mund të komunikojnë, në të gjitha fazat e procesit, me përfaqësuesin e tyre ligjor.

Pas një aktvendimi fillestar, gjykata mund t'i mbajë individët në paraburgim deri në 30 ditë nga dita e arrestimit, dhe mund ta vazhdojë paraburgimin deri në një vit. Pas ngritjes së aktakuzës e deri në përfundim të procedurës gjyqësore, vetëm gjykatësi i rastit apo trupi gjykues mund ta caktojë apo ndërpresë paraburgimin. Ligji lejon që gjykatësi të urdhërojë arrestin shtëpiak, konfiskimin e dokumenteve të udhëtimit dhe përdorimin e gjerë të dorëzarisë si alternativa ndaj paraburgimit.

Ndonëse në disa raste policët ishin sekretë, ata në përgjithësi i kryenin arrestimet duke përdorur urdhërarreste. Nuk pati raportime të konfirmuara që policia abuzoi rregullin 48-orësh, dhe prokurorët në përgjithësi ose u ofronin personave të arrestuar dokumente në të cilat cekeshin arsyet për ndalimin e tyre ose i lironin. Ndonëse zyrtarët në përgjithësi e respektuan kriterin për zgjidhje të shpejtë të rasteve, Qendra për Rehabilitimin e Viktimave të Torturës raportoi se të ndaluarit nganjëherë përballeshin me vonesa kur avokatët përkohësisht nuk ishin në dispozicion.

Qendra për Rehabilitimin e Viktimave të Torturës raportoi se autoritetet nuk i lejonin gjithmonë personat e ndaluar të kontaktonin me avokatë me rastin e arrestimit dhe në disa raste u lejonin konsultime me avokat vetëm pasi hetuesit policorë kishin filluar marrjen formale në pyetje. Në disa raste, të ndaluarve iu lejua qasja në avokat vetëm pas përfundimit të marrjes formale në

KOSOVA

pyetje. Disa të ndaluar ankoheshin se, përkundër kërkesës për avokat, kontakti i tyre i parë me avokatin ndodhte vetëm pas paraqitjes së tyre të parë në gjykatë.

Ligji ia kufizon policisë përdorimin e forcës vetëm për ta “mbrojtur jetën e një personi, për ta parandaluar një sulm, për ta parandaluar një vepër penale, për ta parandaluar arratisjen e kryesit ose, kur masat e tjera nuk janë të suksesshme, për ta arritur një synim tjetër të ligjshëm policor”. Ligji gjithashtu parashikon që kur përdoret forca, policia “do të përpiqet ta minimizojë ndërhyrjen në të drejtat dhe liritë e një personi dhe ta minimizojë çdo pasojë të dëmshme”.

Qendra për Rehabilitimin e Viktimave të Torturës raportoi se IPK-ja ishte më energjike në ndjekjen e rasteve të keqpërdorimeve gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare në krahasim me vitet paraprake. Inspektorati i arrestoi 27 dhe i suspendoi 65 policë në gjysmën e parë të vitit; “keqtrajtimi” dhe “keqpërdorimi i autoritetit zyrtar” u renditën si dy veprat penale më të zakonshme për këta policë.

Paraburgimi: Paraburgimet e gjata, mesatarisht gjashtë muaj, para dhe gjatë procedurës gjyqësore, mbetën problem. Ligji u lejon gjykatësve ta ndalojnë të pandehurin në pritje të gjykimit nëse ekziston dyshimi i bazuar se i pandehuri ka të ngjarë t’i shkatërrojë, fshehë apo falsifikojë provat, të ndikojë në dëshmitarë, të ikën, ta përsërisë veprën penale, të kryejë ndonjë vepër tjetër penale, apo të mos paraqitet në procedura gjyqësore. Gjykatësit zakonisht e përdornin paraburgimin pa kërkuar arsyetim të mbështetur në prova. Paraburgimi i gjatë ndodhte gjithashtu për shkak të joefikasitetit dhe korrupsionit në gjyqësor.

e. Mohimi i gjykimit të drejtë publik

Kushtetuta parashikon një gjyqësor të pavarur, por gjyqësori nuk ofronte gjithmonë proces të drejtë. Sipas Komisionit Evropian, OJQ-ve dhe Institucionit të Avokatit të Popullit, administrimi i drejtësisë ishte i ngadalshëm dhe i mungonin mjetet për të siguruar llogaridhënie nga zyrtarët gjyqësorë. Strukturat gjyqësore i nënshtroheshin ndërhyrjes politike, me emërimet të diskutueshme dhe mandate të paqarta.

Ndonëse numri i lëndëve të grumbulluara dikur paraqiste problem të madh, efikasiteti i gjyqësorit në zgjidhjen e lëndëve të grumbulluara vazhdoi të përmirësohej.

Këshilli Gjyqësor lëshoi vërejtje jopublike me shkrim ose ulje të pagave për katër gjykatës, ndonëse këto sanksione u konsideruan të pamjaftueshme për ta parandaluar ndjeshëm sjelljen e keqe në të ardhmen. Këshilli Prokurorial nisi katër hetime dhe lëshoi dy vendime, përfshirë një konstatim të fajësisë, të cilin Gjykata Supreme e rrëzoi më pas. Edhe Këshilli Gjyqësor, edhe Këshilli Prokurorial i publikuan vendimet përfundimtare disiplinore në ueb faqet e tyre përkatëse, ndonëse publikimi nga Këshilli Prokurorial shpesh vonohej.

Autoritetet nganjëherë nuk i zbatuan urdhrat e gjykatave, përfshirë urdhrat e Gjykatës Kushtetuese. Disa përfaqësues të serbëve të Kosovës pohuan se institucionet qeveritare dështuan në ekzekutimin e vendimeve gjyqësore në favor të serbëve të Kosovës, posaçërisht në kontestet që kanë të bëjnë me pronën. Autoritetet qendrore dhe lokale në Deçan vazhduan ta refuzojnë zbatimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese të vitit 2016 që e konfirmonte

KOSOVA

pronësinë e Kishës Ortodokse Serbe për më shumë se 24 hektarë tokë afër Manastirit të Deçanit. Në shtator, Gjykata Kushtetuese theksoi refuzimin e vazhdueshëm të qeverisë për ta zbatuar vendimin e Gjykatës dhe ia referoi çështjen Prokurorit të Shtetit. Që nga dhjetori, Prokurori nuk kishte filluar procedurë penale. Asnjëri prej zyrtarëve që nuk e kanë zbatuar urdhrin e gjykatës nuk është sanksionuar.

Procedurat e gjykimit

Ligji parashikon gjykim të drejtë e të paanshëm dhe, edhe pse pati të meta të mëdha në sistemin e drejtësisë, përshirë rastet e ndërhyrjes politike, ligji në përgjithësi u respektua. Gjykimet janë publike dhe të pandehurit gëzojnë: prezumimin e pafajësisë; të drejtën për t'u informuar me kohë dhe hollësisht për akuzat kundër tyre; për gjykim të drejtë, me kohë e publik ku gjykatës mund t'i drejtohen në gjuhën e tyre amtare; të drejtën për të qenë të pranishëm në gjykimet e veta; të heshtin dhe të mos detyrohen të dëshmojnë apo ta pranojnë fajësinë; të përballen me dëshmitarë; t'i shohin provat dhe të kenë përfaqësim ligjor. Të pandehurit kanë të drejtë të ankohen. Këto të drejta u ofrohen të gjithë qytetarëve pa përjashtim. Vendi nuk mban gjykime me juri.

Kushtetuta e përcakton ndihmën juridike falas si të drejtë themelore të njeriut dhe ligji garanton ndihmë juridike falas në çështje civile, çështje administrative, kundërvajtje dhe procedura penale për individët që përmbushin kriteret e caktuara ligjore dhe financiare. Agjencia e Qeverisë për Ndihmë Juridike Falas ofron ndihmë juridike falas për individë me të ardhura të ulëta. Gjatë vitit, ajo ndërmoi fushata informuese që synonin komunitetet e cenuara e të marginalizuara dhe shpërndau informacione për ndihmë juridike përmes platformave online.

Të burgosurit dhe të arrestuarit politikë

Nuk pati raportime për të burgosur apo të arrestuar politikë.

Procedurat dhe mjetet juridike civile

Ka mjete juridike civile për shkelje të të drejtave të njeriut, por viktimat nuk mund ta shfrytëzonin këtë të drejtë për shkak të procedurave të ndërlikuara burokratike dhe numrit të madh të lëndëve të grumbulluara. Individët mund të ankohen në gjykata për të kërkuar dëmshpërblim për shkelje apo ndalim të shkeljes së të drejtave të njeriut.

Individët mund t'i drejtohen Gjykatës Kushtetuese për shqyrtimin e shkeljeve të pretenduara nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale të garantuara me kushtetutë, por vetëm pas shterimit të të gjitha mjeteve të tjera juridike.

Sekuestrimi dhe rikthimi i pronës

Një përzierje konfuze e ligjeve, rregulloreve, udhëzimeve administrative dhe praktikave gjyqësore, si dhe rizënia ilegale e pronave dhe pretendimet e shumta për të njëjtën pronë, vazhduan ta pengonin zgjidhjen e rasteve të rikthimit të pronës që buronin nga lufta dhe pas saj. Mbi 95 për qind të këtyre ankesave ishin parashtruar nga serbët. Qytetarët e rëndomtë dhe

KOSOVA

komunitetet fetare nuk ishin shumë të suksesshëm në paraqitjen e kërkesave për rikthim të pronës së sekuestruar apo të konfiskuar gjatë kohës së Jugosllavisë.

Sipas ligjit, Agjencia Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës ka autoritetin për t'i gjykuar pretendimet lidhur me sipërfaqen, vlerën dhe pronësinë e parcelave të tokës dhe për t'i zgjidhur mospërputhjet ndërmjet dokumenteve kadastrale. Mungesa e regjistrave kadastrale, që Serbia i largoi nga Kosova në vitin 1999 dhe vazhdon t'i mbajë, e pengoi agjencinë që ta përmbushte plotësisht mandatin e saj. Parashtruesit e kërkesave kanë të drejtë të ankohen kundër vendimeve në gjykata.

Agjencia për Krahasim dhe Verifikim të Pronës kishte vështirësi në zbatimin e vendimeve për dëbimin e uzurpuesve të paligjshëm dhe në përgjithësi dështoi në largimin e strukturave ilegale të ndërtuara në tokë pasi parashtruesve të kërkesave u ishte konfirmuar e drejta e tyre. Shumica e parashtruesve të kërkesave ishin serbë. Pas një udhëzimi administrativ të vitit 2020 për heqjen e strukturave ilegale, vetëm një rrënim ka ndodhur, në tetor 2020 në Prishtinë. Që nga korriku, nuk ka pasur zhvillime të tjera. Riuzurpimi i pronës vazhdoi të ishte problem, edhe pse shifrat gjoja kanë rënë. Në qershor, OJQ-ja Aktiv, e udhëhequr nga serbët e Kosovës, publikoi një raport ku sugjeronte që problemet si falsifikimi i dokumenteve, mospajtimi me vendimet e gjykatës, dëmtimi i qëllimshëm ose shkatërrimi i plotë i pronës dhe uzurpimi i pronës, i pengonin disa serb të Kosovës për t'i gëzuar të drejtat e tyre pronësore. Në një përpjekje për ta forcuar mbrojtjen e të drejtave pronësore, OJQ-ja Qendra Avokuese për Kulturë Demokratike, e udhëhequr nga serbët e Kosovës, e hapi një ueb sajt në nëntor, ku parashtruesve të kërkesave pronësore u ofronte ndihmë ligjore dhe informacione.

Në shtator 2020, Kryeministri Hoti dhe Presidenti serb Vuçiq nënshkruan veçmas marrëveshje që përfshinin zotimet për ta vazhduar rikthimin e pronës hebreje të patrashëgimtarë dhe të pakërkuar të kohës së Holokaustit. Raporti i Aktit të Departamentit të Shtetit për Drejtësinë për të Mbijetuarit e Pakompensuar Sot (JUST) drejtuar Kongresit, i cili mbulon kthimin e pronave, si dhe kujtimin e Holokaustit, kërkimin dhe edukimin nga vendet që e miratuan Deklaratën e Terezinit në vitin 2009, u publikua më 29 korrik 2020, dhe mund të gjendet në ueb sajtin e Departamentit në: <https://www.state.gov/reports/just-act-report-to-congress/>. Vendi nuk e miratoi Deklaratën e Terezinit në vitin 2009 dhe nuk është i përfshirë në raportin JUST.

f. Ndërrhyrja arbitrare ose e paligjshme në intimitet, familje, shtëpi apo korrespondencë

Kushtetuta dhe ligji ndalojnë veprime të tilla dhe nuk pati raportime që Qeveria, EULEX-i apo KFOR-i nuk i respektuan këto ndalesa.

Seksioni 2. Respektimi i lirive civile

a. Liria e shprehjes, përfshirë për anëtarët e shtypit dhe të mediave të tjera

Kushtetuta dhe ligji parashikojnë lirinë e shprehjes, përfshirë lirinë e shtypit dhe të mediave të tjera. Ndonëse Qeveria në përgjithësi e respektoi këtë të drejtë, pati raportime të besueshme që disa zyrtarë publikë, politikanë, biznese dhe grupe radikale fetare përpiqeshin t'i kërcënonin përfaqësuesit e mediave. Problemet financiare gjithashtu e dëmtuan pavarësinë e mediave.

Raportet e Shtetit mbi Praktikën e të Drejtave të Njeriut për vitin 2021
Departamenti i Shtetit i Shteteve të Bashkuara • Zyra për Demokraci, të Drejta të Njeriut dhe Punë

KOSOVA

Gazetarët hasën në vështirësi me rastin e marrjes së informatave nga Qeveria dhe institucionet publike, pavarësisht ligjeve që sigurojnë qasje në dokumentet publike. Komisioni i Pavarur për Media i rregullon frekuencat e transmetimit, lëshon licenca për transmetuesit publikë dhe privatë, dhe vendos për politikën e transmetimit.

Liria e shprehjes: Në korrik, Gjykata Themelore e Prishtinës e dënoi shtetasin malazez Risto Jovanović me gjashtë muaj burg për nxitje të jotolerancës, brohoritje të parullave nacionaliste, gjatë përkujtimit të Betejës së Kosovës (Vidovdan) të 28 qershorit 1389 në Gazimestan, Prishtinë. Gjykata e gjobiti Jovanovićin me 6.700 euro (7.700 dollarë) në vend të burgimit dhe ia ndaloi hyrjen në vend për pesë vjet.

Liria e shprehjes për anëtarët e shtypit dhe të mediave të tjera, përfshirë mediat elektronike: Mediat e pavarura ishin aktive dhe shprehën një gamë të gjerë të pikëpamjeve, në përgjithësi pa kufizim. Megjithatë, pati raportime që zyrtarë qeveritarë, disa parti politike, biznese të lidhura me Qeverinë, grupe fetare dhe individë të pakënaqur ushtruan trysni ndaj pronarëve të mediave, redaktorëve individualë dhe reporterëve për të mos publikuar storje apo materiale të caktuara. Disa gazetarë u përmbajtën nga raportimi kritik hulumtues për shkak të frikës për sigurinë e tyre fizike ose sigurinë e punës.

Ndonëse disa medime financiarisht të pavarura zhvilluan politika redaksionale dhe transmetuese të pavarura nga interesat politike dhe afariste, mediumet me më pak burime nganjëherë pranuan ndihmë financiare në shkëmbim për raportim pozitiv apo mospublikim të storjeve negative që do të mund t'i dëmtonin interesat e financuesve. Sipas disa redaktorëve, financimi ishte i kufizuar pjesërisht për shkak të ngurrimit të qeverisë për t'i reklamuar programet e saj në mediat që publikonin materiale kritike për politikën e qeverisë.

Sipas Asociacionit të Gazetarëve të Kosovës, në shtator Haki Abazi, deputet i partisë në pushtet, Vetëvendosje, e kërcënoi median online, *Albanian Post*, dhe drejtorin e saj për raportimin e tyre për emërimin e ambasadorëve nga qeveria. Mediumi e postoi një incizim të incidentit të supozuar në internet.

Dhuna dhe ngacmimi: Që nga dhjetori, Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës raportoi për 26 raste në të cilat zyrtarë qeveritarë, grupe afariste, grupe të komunitetit apo grupe fetare e cenuan lirinë e shtypit duke i sulmuar fizikisht ose kërcënuar gojarisht gazetarët.

Në fund të shkurtit, gazetari hetues, Visar Duriqi, u sulmua jashtë shtëpisë së tij nga tre persona të cilët thuhej se po e prisnin kthimin e tij. Ai u lëndua shumë, përfshirë hundën e thyer dhe humbjen e dhëmbëve, dhe kërkoi trajtim në spital. Raportimi i Duriqit shpesh e mbulonte krimin dhe korrupsionin, përfshirë analizën për keqpërdorim të subvencioneve bujqësore, për të cilat ai foli në stacionin televiziv lokal Kanal-10 në mbrëmjen kur u sulmua. Policia i ka nisur hetimet për incidentin, por asnjë i dyshuar nuk është identifikuar. Avokati i Popullit e cilësoi dhunën si sulm ndaj lirisë së shprehjes.

Më 17 prill, hetuesit policorë e intervistuan Parim Ollurin, drejtor i agjencisë së lajmeve online *Insajderi*, lidhur me raportimin e revistës për dështimin e pretenduar të Ministrisë të Shëndetësisë për ta nënshkruar blerjen zyrtare të vaksinave Pfizer për COVID-19. Olluri pohoi

KOSOVA

se policia i kërkoi atij t'i identifikonte burimet e tij të informacionit. Asociacioni i Gazetarëve dhe shoqëria civile e dënuan policinë dhe qeverinë për gjoja shkeljen e Ligjit për Mbrojtjen e Burimeve të Gazetarëve.

Më 13 tetor, protestuesit i sulmuan disa gazetarë të mediave në gjuhën shqipe dhe serbe (përfshirë Radion Evropa e Lirë) që i mbulonin protestat në Mitrovicën e Veriut pas një operacioni kundër kontrabandës të kryer nga policia. Gazetarët raportuan se protestuesit ua morën dhe ua thyen video pajisjet, i ndoqën gazetarët në këmbë dhe në vetura dhe hodhën gurë, kokteje Molotovi dhe pajisje të tjera shpërthyes në media.

Censurimi ose kufizimi i përmbajtjes: Nuk pati raportime për censurim të drejtpërdrejtë të mediave të shkruara apo elektronike, megjithatë, gazetarët pohojnë që presioni nga politikanët dhe grupet e organizuara kriminale shpesh rezultonte në vetëcensurim. Disa gazetarë përmbaheshin nga raportimi hetues kritik për shkak të frikës për sigurinë e tyre fizike apo për sigurinë e vendit të tyre të punës. Gazetarët nganjëherë pranonin oferta të përfitimeve financiare në këmbim për raportim pozitiv apo heqje dorë nga hetimi.

Sipas Asociacionit të Gazetarëve, zyrtarë qeveritarë, dhe kriminelë të dyshuar, gojarisht i kërcënonin gazetarët për raportimin që konsiderohej negativ. Sipas disa redaktorëve, agjencitë qeveritare dhe korporatat i tërhiqnin reklamën nga gazetat që publikonin material kritik për ta.

Gazetarët u ankuan që pronarët dhe menaxherët e mediave nuk i lejonin të publikonin apo transmetonin storje kritike për Qeverinë, partitë politike apo zyrtarë të caktuar. Në disa raste, gazetarët raportonin që pronarët e mediave i kërcënonin se do t'i largonin nga puna po të shkruanin raporte kritike. Gazetarët gjithashtu u ankuan që pronarët e mediave i ndalonin të raportonin për korrupsion të nivelit të lartë në Qeveri.

Që nga gushti, Institucioni i Avokatit të Popullit ishte duke i hetuar 26 ankesa nga mediat, organizatat e shoqërisë civile dhe qytetarët individualë për shkelje të supozuara të së drejtës për qasje në dokumente publike. Institucioni i Avokatit të Popullit arriti në përfundimin se institucionet publike nuk kishin kapacitet profesional dhe staf për t'iu përgjigjur kërkesave për qasje në dokumente publike, duke çuar ose në vonesa të mëdha, ose në dështime në ofrimin e arsyetimit ligjor për refuzim ose kufizim të qasjes.

Liria e internetit

Qeveria nuk e kufizoi ose ndërpreu qasjen në internet apo censuroi përmbajtjen në internet, dhe nuk pati raportime të besueshme që Qeveria i monitoronte bisedat private në internet pa leje përkatëse ligjore.

Liria akademike dhe ngjarjet kulturore

Qeveria nuk i kufizoi ngjarjet kulturore. Sistemi arsimor u nënshtrohej emërimeve politike të drejtorëve të shkollave dhe të mësimdhënësve në të gjitha nivelet.

KOSOVA

b. Liria e tubimit paqësor dhe asociimit

Kushtetuta dhe ligji parashikojnë lirinë e tubimit paqësor dhe asociimit, dhe Qeveria në përgjithësi i respektoi këto të drejta.

c. Liria e fesë

Shih *Raportin ndërkombëtar mbi liritë fetare* të Departamentit të Shtetit në: <https://www.state.gov/religiousfreedomreport/>.

d. Liria e lëvizjes dhe e drejta për t'u larguar nga vendi

Ligji parashikon lirinë e lëvizjes brenda vendit, udhëtimin jashtë vendit, emigrimin dhe riatdhesimin, dhe Qeveria në përgjithësi i respektoi këto të drejta.

Pakicat etnike kishin qasje në dokumente të identitetit në regjistrin civil, dhe numri i serbëve të Kosovës me këto dokumente vazhdoi të rritej. Përfaqësuesit e serbëve të Kosovës pohuan se mbetën disa sfida, si qasja në dokumente civile për shtetasit serbë të martuar me qytetarë serbë të Kosovës.

Lëvizja brenda vendit: Ura kryesore që i lidh Mitrovicën e Veriut dhe të Jugut mbeti e mbyllur për qarkullim të veturave, gjoja për t'i parandaluar trazirat civile, por ishte plotësisht e hapur për këmbësorë. KFOR-i dhe policia mbajtën siguri të përhershme në atë lokacion. Urat e tjera që i lidhin këto dy qytete ishin plotësisht të hapura.

Mërgimi: Kthimi në vend i refugjatëve të pakicave etnike që ishin larguar gjatë luftës mbeti problem. Përfaqësuesit parlamentarë të komunitetit ashkali, egjiptian dhe rom raportnin që paragjykimi shoqëror e pengonte kthimin e rreth 400 anëtarëve të komuniteteve të tyre. Këta persona më parë ishin banorë të këtij vendi dhe e informuan Zyrën e Komisarariatit të Lartë të OKB-së për Refugjatë (UNHCR) se ata ishin të gatshëm të ktheheshin nga Serbia, Maqedonia e Veriut dhe Mali i Zi.

e. Statusi dhe trajtimi i personave të zhvendosur brenda vendit

UNHCR-ja raportoi se një numër i madh i individëve vazhdoi të kishte nevoja të lidhura me zhvendosjen që buronin nga konflikti i vitit 1998-99 dhe ngjarjet e dhunshme të vitit 2004, përfshirë 15.699 persona të zhvendosur brenda vendit.

Ndërsa UNHCR-ja vazhdoi ta mirëmbante bazën e vet të dhënave të brendshme për të kthyerit dhe aplikacionet për ndihmë, Ministria për Komunitete dhe Kthime i filloi procedurat për ta krijuar bazën e vet të dhënave për personat e zhvendosur, refugjatët dhe të kthyerit. Sipas Ministrisë për Komunitete dhe Kthime, barrierat për kthim përfshinin diskriminimin e gjerë të anëtarëve të komuniteteve pakicë, frikën nga dhuna ose ngacmimi, dështimin për t'i zbatuar vendimet e gjykatës (veçanërisht ato në lidhje me pronën), uzurpimin e pronës, mungesën e qasjes në mundësitë arsimore dhe ekonomike, mungesën e shërbimeve publike në

Raportet e Shtetit mbi Praktikën e të Drejtave të Njeriut për vitin 2021
Departamenti i Shtetit i Shteteve të Bashkuara • Zyra për Demokraci, të Drejta të Njeriut dhe Punë

KOSOVA

një gjuhë të përbashkët, përfaqësimin e kufizuar të komuniteteve pakicë në institucionet dhe ndërmarrjet publike dhe koordinimin dhe bashkëpunimin e kufizuar ndërmjet organeve qeveritare për t'i adresuar çështjet shqetësuese. UNHCR-ja theksoi se qeverisë i mungonte një sistem për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave për popullatat e zhvendosura dhe kthimet vullnetare në vend dhe se mungesa e një regjistrimi të detajuar dhe profilizimi adekuat i të dhënave i lanë personat e zhvendosur pa mbrojtje të të drejtave të njeriut dhe plane për zhvillim.

Qeveria promovoi kthimin e sigurt dhe vullnetar të personave të zhvendosur brenda vendit (PZHBV). Përmes Ministrisë për Komunitete dhe Kthime, ajo promovoi politika dhe mbrojtje për PZHBV-të në përputhje me politikatat e BE-së dhe bashkëpunoi me organizatat vendore e ndërkombëtare për ta siguruar qasjen e PZHBV-ve në pronat e tyre dhe në mjete për kthimin e tyre të qëndrueshëm. Këto përfshijnë ndihmën për riposedim të pronës, ndarjen e tokës për shtëpi, dhe perspektiva të përmirësuar socio-ekonomike.

Personat e zhvendosur dhe të kthyerit romë, ashkali dhe egjiptianë vazhduan të përballeshin me kushte shumë të vështira të jetesës. Një nga sfidat kryesore ishte rezistenca e disa komunave për të ndarë tokë dhe për t'i njohur të drejtat e qiramarrjes ose posedimit bazuar në vendbanimet joformale që anëtarët e këtyre komuniteteve i kishin zënë para zhvendosjes. Disa komuna nuk arritën të ndajnë tokë për komunitetin rom, ashkali dhe egjiptian që kishin marrë të drejta pronësore brenda komunave, për shkak se kishin jetuar diku tjetër para zhvendosjes së tyre.

Në janar, mediat raportuan se financimi i përbashkët nga Zyra e BE-së, Këshilli Danez për Refugjatë dhe komuna e Shtërpçës u mundësoi ish-PZHBV-ve nga një qendër kolektive (strehimore e përkohshme) në Shtërpçe të vendosen në 110 njësi banesore. Me mbështetjen e BE-së dhe të Këshillit Danez për Refugjatë, Ministria për Komunitete dhe Kthime raportoi se ka përfunduar ndërtimin e njësisë banesore për disa PZHBV që jetojnë në Graçanicë.

Sipas të dhënave të UNHCR-së, 139 persona të zhvendosur ende jetonin në 15 qendra kolektive në vend.

Nga fundi i qershorit, Ministria për Komunitete dhe Kthime raportoi se, me mbështetjen e BE-së, e kishte përfunduar ndërtimin e dy shtëpive për të kthyerit dhe kishte filluar ndërtimin e tetë shtëpive të tjera. Ministria dorëzoi pajisje shtëpiake, ushqim, material ndërtimor dhe pajisje të tjera të nevojshme për ta lehtësuar rivendosjen. Sipas nismës së mbështetur nga BE-ja, Ministria gjithashtu ndihmoi në financimin e 41 projekteve individuale të biznesit të vogël dhe të shtatë projekteve infrastrukturore për komunitetet e PZHBV-ve.

Procesi i kthimit në disa zona të vendit vazhdoi të shënohej nga incidente të sigurisë dhe ngurrimi i komuniteteve lokale për ta pranuar kthimin e serbëve ose vizitat nga serbët e Kosovës. Që nga korriku, UNHCR-ja raportoi për gjithsej 19 incidente që i preknin të kthyerit dhe PZHBV-të, kryesisht në rajonin e Pejës. Në qershor, Dragica Gashiq, serbja e parë e Kosovës që e rimori pronën në Gjakovë, përjetoi kundërshtim të fortë nga komuniteti, përfshirë nga degët e partive politike lokale dhe shoqatat e të zhdukurve dhe të të vrarëve gjatë luftës së vitit 1999. Gashiq raportoi për ngacmime të shpeshta nga fqinjët dhe bizneset lokale, përfshirë fyerjen dhe frikësimin. Më 27 korrik, Gashiq u raportoi autoriteteve se dikush kishte hyrë me dhunë në shtëpinë e saj dhe kishte vjedhur gjësende. Sipas raportimeve të mediave, Gashiq e

KOSOVA

ka riposeduar banesën në mënyrë ligjore përmes Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës. Në korrik, mediat raportuan se persona të panjohur i kanë shkaktuar lëndime të rënda trupore një serbi të zhvendosur që kishte ardhur për ta vizituar pronën e tij në komunën e Klinës. Policia nisi një hetim.

f. Mbrojtja e refugjatëve

Qeveria bashkëpunoi me Zyrën e UNHCR-së dhe organizata të tjera humanitare në ofrimin e mbrojtjes dhe ndihmës për refugjatët, refugjatët e kthyer, azilkërkuesit dhe personat e tjerë të shqetësuar.

Qasja në azil: Ligji parashikon dhënien e statusit të azilit ose refugjatit me mbrojtje plotësuese, një sistem për t'u siguruar mbrojtje refugjatëve, dhe pranim të përkohshëm të azilkërkuesve gjersa rastet e tyre gjykohen. Qeveria ka një sistem që u mundëson shtetasve të huaj ose personave pa shtetësi të kërkojnë azil në çdo pikë hyrjeje në territor ose brenda territorit. Vendi nuk ka sistem për menaxhimin e migrimit në nivelin qendror, megjithatë, ka një sistem për identifikimin, kontrollimin dhe referimin e personave që kërkojnë mbrojtje azili dhe të personave me nevoja të veçanta brenda fluksit të përzier të migrimit.

Objektet e pranimin në qendrën për azil mund të pranojnë fëmijë, por objektit i mungonin procedurat standarde të operimit për trajtimin e fëmijëve të pashoqëruar që kërkonin azil ose për përcaktimin e të drejtës së tyre për azil. Rastet e azilit shënuan rënie nga vitet e kaluara, dhe vendi është kryesisht vend tranzit. Ata që kërkonin azil zakonisht largoheshin nga vendi dhe nuk merrnin pjesë në seancat e tyre.

Deportimi: Në gusht 2019, IPK-ja ngriti akuza në prokurori kundër 22 policëve që morën pjesë në një operacion që përfshinte heqjen e lejeve të qëndrimit në vitin 2018 dhe deportimin pasues në Turqi të gjashtë shtetasve turq, të cilët Turqia i akuzonte se kishin lidhje me terrorizmin. Në vitin 2019, Gjykata e Apelit e konfirmoi një aktvendim paraprak se arsyetimi për heqjen e lejeve të qëndrimit ishte i pabazë. Që nga dhjetori, Ministria e Punëve të Brendshme nuk kishte marrë asnjë aktgjykim të formës së prerë nga gjykata. Në shkurt, ZPS-ja ngriti aktakuzë kundër ish-drejtorit të Agjencisë Kosovare të Inteligjencës dhe dy zyrtarëve të lartë të Ministrisë së Punëve të Brendshme për keqpërdorim të detyrës zyrtare për deportimin e shtetasve turq.

Qasja në shërbimet themelore: UNHCR-ja raportoi se azilkërkuesit morën strehim, ushqim të rregullt dhe veshmbathje, ndërsa organizatat partnere të UNHCR-së ofruan vlerësime psikologjike, shërbime këshillimi dhe ndihmë juridike. Mungesa e shërbimeve të përkthimit për disa gjuhë zyrtare mbeti problem në nivelin qendror e lokal. UNHCR-ja pohonte që kujdesi shëndetësor dhe trajtimi psikologjik ende nuk ishin adekuat. Sipas Organizatës Ndërkombëtare për Migrim, pavarësisht nga një proces i drejtpërdrejtë i regjistrimit, qeveria nuk u ofroi të sapoardhurve qasje të menjëhershme në shërbimet dhe procedurat e azilit, gjë që rezultoi në një numër të konsiderueshëm të aplikacioneve të grumbulluara.

Qeveria bashkëpunoi me UNHCR-në për ta caktuar një qendër ndalimi për të huajt, si vend karantinë për të sapoardhurit, dhe për të siguruar pajisje mbrojtëse personale dhe sende të higjienës për azilkërkuesit. UNHCR-ja siguroi qasje në shërbime të internetit në qendrat e azilit

KOSOVA

për t'u ofruar azilkërkuesve ndihmë ligjore dhe psikosociale në internet, si dhe arsimim për fëmijët.

Qeveria prezantoi rregullore që mandatojnë mbështetjen dhe integrimin për azilkërkuesit, refugjatët, personat me mbrojtje të përkohshme ose mbrojtje shtesë dhe personat pa shtetësi, por ende është duke i përfunduar procedurat standarde të operimit.

Mbrojtja e përkohshme: Qeveria u siguroi mbrojtje të përkohshme, të ashtuquajtur mbrojtje shtesë, individëve që mund të mos kualifikohen si refugjatë. Gjatë shtatorit, qeveria u ofroi mbrojtje shtesë mbi 1.000 personave, kryesisht afganë, në mbështetje të Operacionit Refugjatët e Aleatëve.

g. Personat pa shtetësi

Shifrat zyrtare për persona pa shtetësi nuk ishin në dispozicion. Ligji nuk përmban dispozita diskriminuese që mund të shkaktojnë që grupeve apo individëve t'u hiqet apo mohohet shtetësia. Fëmijët e fitojnë shtetësinë nga prindërit e vet. Fëmijët e lindur nga prindërit që nuk janë shtetas të Kosovës e fitojnë shtetësinë për shkak të lindjes në vend; kjo situatë më së shpeshti ndodh me anëtarët e komuniteteve pakicë, me numër të madh të banorëve, shtetësia e të cilëve nuk është e dokumentuar. Procedurat e qeverisë parashikojnë qasje në natyralizim për personat që e marrin statusin e personit pa shtetësi apo të refugjatit pesë vjet pas paraqitjes së kërkesës.

Ligjet që kanë të bëjnë me gjendjen civile u mundësojnë personave pa shtetësi t'i regjistrojnë lindjet, martesat dhe vdekjet, dhe zbatimin e tyre ndryshonte nga komuna në komunë. Kapaciteti i qeverisë për t'i identifikuar personat pa shtetësi dhe personat me shtetësi të papërcaktuar mbeti joadekuat.

Banorët e paregjistruar nuk morën përfitime të ndihmës sociale, nuk kishin të drejtë në pension dhe nuk mund të regjistronin tituj pronësie ose t'i mbanin të drejtat për pronë të trashëguar apo të transferuar. Fëmijëve të lindur nga prindërit e zhvendosur jashtë vendit dhe të cilët kanë hyrë me prindërit e tyre të ripranuar, shpesh u mungonte dokumentacioni, përfshirë certifikatat e lindjes, nga vendi i tyre i lindjes. UNHCR-ja ofroi ndihmë juridike për regjistrimin civil të afërsisht 100 romëve, ashkalinjve dhe egjiptianëve të paregjistruar.

Seksioni 3. Liria për të marrë pjesë në proces politik

Ligji parashikon të drejtën e qytetarëve për ta zgjedhur qeverinë e tyre përmes zgjedhjeve periodike të lira e të drejta, me votim të fshehtë, në bazë të votimit të përgjithshëm e të barabartë.

Qeveria serbe vazhdoi t'i drejtonte disa struktura paralele ilegale qeveritare në komunat me shumicë serbe në Kosovë dhe në zonat e banuara kryesisht nga komuniteti goran. Qeveria serbe shpesh i përdorte këto struktura për të ndikuar në komunitetet serbe dhe gorane dhe në përfaqësuesit e tyre politikë.

KOSOVA

Zgjedhjet dhe pjesëmarrja politike

Zgjedhjet e fundit: Vendi i mbajti zgjedhjet e jashtëzakonshme parlamentare në shkurt. Vëzhgues ndërkombëtarë dhe të pavarur, si dhe përfaqësues të grupeve të pakicave etnike treguan për presion dhe frikësim brenda komuniteteve të pakicave etnike për t'i mbështetur partitë e lidhura me Listën Serbe, një parti e lidhur ngushtë me qeverinë serbe. Disa serbë të Kosovës gjithashtu raportuan se u është bërë presion për të mos mbështetur parti të tjera përveç Listës Serbe. Sipas vëzhguesve të Institutit Kombëtar Demokratik, politikanët e Listës Serbe nxitën krijimin e partive të reja politike romë dhe boshnjake dhe i inkurajuan serbët e Kosovës që të votonin për këto parti të reja në përpjekje për ta rritur ndikimin e tyre në Kuvend duke i fituar vendet e rezervuara për grupet e pakicave.

Në mars, Gjykata Supreme anuloi shumicën e votave të hedhura për partinë e Iniciativës Rome dhe partinë Komuniteti i Bashkuar - Adrijana Hoxhiq, të lidhura me Listën Serbe, duke pohuar se votat e tyre nuk erdhën nga komunitetet që synonin t'i përfaqësonin vendet e garantuara. Vendimi i Gjykatës Supreme bëri që Hoxhiq ta humbasë vendin e saj, i cili i shkoi partisë së dytë boshnjake, Bashkimi Social Demokrat. Iniciativa Rome gjithashtu humbi një nga dy vendet që fillimisht dukej se i fitoi, dhe vendi i shkoi një partie tjetër të komunitetit rom.

Më 22 janar, para zgjedhjeve të 14 shkurtit, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve votoi për ta mohuar certifikimin e kandidatëve të çdo partie me një dënim penal në tri vjetët e fundit, në përputhje me ligjet që e rregullojnë të drejtën e fushatës. Të nesërmen, ushtruesja e atëhershme e detyrës së Presidentit, Vjosa Osmani, e kritikoi këtë votim në një deklaratë publike. Më pas, më 14 qershor, Presidentja Osmani e shkarkoi kryetaren e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Valdete Daka, se gjoja ka vepruar në një mënyrë që e ka cenuar rënd pavarësinë dhe integritetin e Komisionit. Njëmbëdhjetë organizata të shoqërisë civile e quajtën vendimin e Osmanit të motivuar politikisht dhe në raportin e Misionit të BE-së për Vëzhgimin e Zgjedhjeve thuhej se "Vendimi i Presidentes së Kosovës për shkarkimin e ish-kryetares së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve më 14 qershor, katër vjet para skadimit të mandatit të saj të dytë dhe vetëm një ditë para shpalljes së zgjedhjeve komunale, nuk ka mundur të arsyetohet në mënyrë adekuate as me arsyetimin e vendimit dhe as me arsyet e renditura në Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme. Të dyja vendimet shihen, sidomos nga partitë opozitare dhe shoqëria civile, si të motivuara politikisht".

Partitë politike dhe pjesëmarrja politike: Partitë politike vepruan lirshëm në pjesën më të madhe të vendit dhe nuk pati pengesa të mëdha për regjistrim. Përkatësia partiake shpesh luante rol në qasjen në shërbimet qeveritare dhe në mundësitë sociale dhe për punësim. Megjithatë, shpresat për partitë opozitare në zonat serbe të Kosovës mbetën të kufizuara për shkak të presionit të raportuar dhe taktikave të frikësimit për të ndikuar në serbët e Kosovës për ta mbështetur Listën Serbe. Në një deklaratë të një vëzhguesi të zgjedhjeve nga BE-ja thuhej se Lista Serbe e kishte monopolizuar jetën politike në komunitetet serbe të Kosovës, duke e kufizuar kështu konkurrencën politike dhe zgjedhjen e votuesve. Në maj, OJQ-ja Iniciativa e Re Sociale, e udhëhequr nga serbët e Kosovës, e publikoi një raport duke theksuar mungesën e pluralizmit politik në komunitetin serb të Kosovës, duke shtuar se mungesa e perceptuar e lirisë dhe presioni nga përfaqësuesit politikë dhe institucionalë e pengonte pluralizmin.

KOSOVA

Pjesëmarrja e grave dhe e anëtarëve të grupeve të pakicave: Asnjë ligj nuk e kufizon pjesëmarrjen e grave apo të anëtarëve të grupeve historikisht të marginalizuara ose të pakicave në procesin politik dhe ato morën pjesë në të. Megjithatë, OJQ-të raportuan se pjesëmarrja e votuesve ndër gra ishte shumë më e ulët sesa ndër votuesit meshkuj. Partitë që përfaqësonin komunitetin rom, ashkali, egjiptian, boshnjak, goran dhe turk bënë fushatë lirshëm në gjuhën e tyre amtare.

Një grua, Vjosa Osmani, shërbeu njëkohësisht si kryetare e Kuvendit dhe ushtruese e detyrës së Presidentit deri në zgjedhjen e saj si Presidente në prill. Një e treta e të gjithë ministrave të kabinetit të Qeverisë së Kryeministrit Kurti ishin gra. Në Kuvend, prej 120 deputetëve, 38 ishin gra, dy më shumë se kuota kushtetuese. Një raport i Freedom House, i vitit 2020, theksoi se shumë grave në zonat rurale u është hequr e drejta e votimit përmes praktikës së votimit familjar, me ç'rast kreu i shtëpisë votonte për tërë familjen.

Përfaqësimi i pakicave etnike në Kuvend ishte më shumë se në proporcion me pjesën e tyre të popullsisë. Partitë politike që i përfaqësonin grupet e pakicave etnike në përgjithësi raportuan për bashkëpunim dhe partneritet më të mirë me Qeverinë e udhëhequr nga Vetëvendosja sesa me paraardhësit e saj.

Seksioni 4. Korrupsioni dhe mungesa e transparencës në qeveri

Ligji parashikon dënime penale për korrupsion ndaj zyrtarëve, por Qeveria nuk e zbatoi ligjin në mënyrë efektive. Pati raportime për korrupsion në Qeveri. Zyrtarët nganjëherë përfshiheshin në praktika korruptive pa u ndëshkuar. Mungesa e mbikëqyrjes efektive gjyqësore dhe dobësia e përgjithshme në sundimin e ligjit i kontribuuan këtij problemi. Rastet e korrupsionit shpesh i nënshtroheshin apelimit të përsëritur dhe sistemi gjyqësor shpesh lejonte parashkrimin e rasteve pa i gjykuar ato.

Korrupsioni: Agjencia e Kosovës kundër Korrupsionit dhe Zyra e Auditorit të Përgjithshëm ndanë përgjegjësinë për luftimin e korrupsionit në Qeveri. PSRK-ja ngriti nëntë aktakuza për korrupsion që nga dhjetori. Një pjesë e vogël e rasteve të korrupsionit që u hetuan dhe u akuzuan përfunduan me dënime. Në qershor, Gjykata Supreme nxori udhëzime për dënimet për korrupsion me qëllim që gjykatave t'u ofrojë udhëzime bazuar në peshën e dëmit dhe shkallën e fajësisë.

OJQ-të dhe organizatat ndërkombëtare pohuan për dështime të shumta të sistemit gjyqësor për ta ndjekur penalisht korrupsionin, duke thënë se shumë pak raste të ngritura kundër zyrtarëve të lartë rezultojnë në aktakuza. Dënimi i zyrtarëve të nivelit të lartë të dënuar për korrupsion shpesh ishte i butë. OJQ-ja Çohu raportoi se shumica e dënimeve rezultojnë në dënime me kusht ose gjoba dhe se vetëm 4 ose 5 për qind rezultojnë me burgim. OJQ-të raportuan se aktakuzat shpesh dështuan për shkak se prokurorët ngitnin akuza të pasakta ose bënë gabime procedurale.

Në prill, Gjykata e Apelit e hodhi poshtë dënimin e vitit 2020 të ish-kryetarit të komunës së Lipjanit, Shukri Buja, duke cituar parashkrimin. Buja u dënua në vitin 2018 për transferim dhe shpronësim të paligjshëm të pronave komunale në një kompani private dhe keqpërdorim të

KOSOVA

pozitës dhe autoritetit zyrtar, të kryer prej vitit 2008 deri në vitin 2010. Në vitin 2019, Gjykata e Apelit urdhëroi rigjykim dhe Buja u dënua me dy vjet burg në shtator 2020. Në janar, Gjykata e Apelit deklaroi se disa nga akuzat ishin parashkruar dhe e uli dënimin e Bujës në një vit. Gjykata Supreme urdhëroi një rigjykim në mars, duke çuar në vendimin e gjykatës në prill për t'i hedhur poshtë të gjitha akuzat.

Që nga nëntori, një vendim mbeti pezull në gjykimin e vitit 2019 të ish-ministrit të Bujqësisë Nenad Rikallo dhe shtatë zyrtarëve të tjerë të Ministrisë të akuzuar për abuzim të pushtetit. Grupi gjoja i anashkaloi masat mbrojtëse ligjore dhe manipuloi me procesin e granteve të Ministrisë për t'u dhënë miliona dollarë kompanive në pronësi të bashkëpunëtorëve politikë.

Seksioni 5. Qëndrimi qeveritar në lidhje me hetimin ndërkombëtar dhe joqeveritar të shkeljeve të supozuara të të drejtave të njeriut

Një numër i madh i grupeve vendore e ndërkombëtare për të drejtat e njeriut në përgjithësi punoi pa u kufizuar nga qeveria, duke i hetuar e publikuar gjetjet e veta për rastet e të drejtave të njeriut. Qeveria bashkëpunonte dhe nganjëherë u përgjigjej pikëpamjeve të tyre.

Organet qeveritare për të drejtat e njeriut: Kushtetuta e përcakton Institucionin e Avokatit të Popullit si institucion kombëtar për të drejtat e njeriut, i mandatar për t'i monitoruar, mbrojtur dhe promovuar të drejtat dhe liritë e individëve nga veprimet e paligjshme ose të pahijshme, ose dështimet për të vepruar, nga autoritetet publike.

Institucioni i Avokatit të Popullit ka kompetencë për t'i hetuar pretendimet për shkelje të të drejtave të njeriut dhe abuzim të autoritetit qeveritar, dhe vepron si Mekanizëm Kombëtar për Parandalimin e Torturës. Ky Institucion është agjencia kryesore përgjegjëse për monitorimin e qendrave të ndalimit. Në bazë të kompetencave të dhëna nga Kuvendi, Institucioni i Avokatit të Popullit mund të paraqesë raste *amicus curiae* në gjykatat themelore për të drejtat e njeriut. Ai gjithashtu mund të japë rekomandime mbi përshtatshmërinë e ligjeve dhe akteve të tjera nënligjore ose administrative, udhëzimeve dhe praktikave.

Seksioni 6. Diskriminimi dhe abuzimet shoqërore

Gratë

Dhunimi dhe dhuna në familje: Ligji e kriminalizon dhunimin dhe dhunën në familje ndaj të gjithë personave, përfshirë dhunimin e një të afërmi/afërmeje ose të bashkëshortit/bashkëshortes. Sipas ligjit, dhunimi dënohet prej 2 – 15 vjet burg. EULEX-i theksoi se gjykatat shpesh shqiptonin dënime më të buta se dënimi më i ulët ligjor për rastet e dhunimit dhe se organet për zbatimin e ligjit rrallë ndërmerrnin masa për t'i mbrojtur viktimat dhe dëshmitarët. Përveç kësaj, këto dënime shpesh uleshin nga Gjykata e Apelit. Zyra e Prokurorisë për Mbrojtjen e Viktimave raportoi për një rritje të numrit të rasteve të dhunës në familje, prej 1.145 rasteve në vitin 2000 në 1.374 raste prej janarit deri në gusht. Rastet e dhunës në baza gjinore, përfshirë dhunën seksuale dhe dhunimin, rrallë raportoheshin nga të mbijetuarit, shpesh për shkak të stigmës shoqërore ose mungesës së besimit në autoritete.

KOSOVA

Ligji e konsideron dhunën në baza gjinore si formë të diskriminimit, por i mungon një përkufizim i dhunës në baza gjinore për t'u përdorur në procedurat penale dhe civile. Zyra e Prokurorisë për Mbrojtjen e Viktimave ndihmoi në sigurimin e qasjes në drejtësi për të mbijetuarit e të gjitha krimeve, me fokus të veçantë në të mbijetuarit e dhunës në familje, trafikimit të personave, abuzimit të fëmijëve dhe dhunimit. Përveç kësaj, çdo prokurori ka një prokuror që ka specializuar në trajtimin e çështjeve të dhunës në familje. Këta prokurorë mund të përdorin mjete për vlerësim të rrezikut për ta ulur rrezikun e abuzimit të ardhshëm dhe atyre u ishte mundësuar të rekomandonin dënime më të ashpra për recidivistët dhe shkelësit e urdhrave mbrojtës.

Policia i hetonte rastet e dhunës në familje para se t'i dërgonte ato te prokurorët të cilët vendosin për ngritje të akuzave. Mirëpo, shkalla e ndjekjes penale ishte e ulët dhe dënimet shpesh uleshin në apel. Avokatët dhe vëzhguesit e gjykatave pohuan se prokurorët dhe gjykatësit favorizuan bashkimin e familjes ndaj mbrojtjes së të mbijetuarve, me urdhra mbrojtës që ndonjëherë e lejonin kryesin të qëndronte në shtëpinë familjare gjersa rasti ishte në procedim. Dënimet sillleshin prej vërejtjeve gjyqësore deri në dënim me burg deri në pesë vjet. Gjykata Themelore e Prishtinës mbajti seanca dëgjimore në internet për rastet e dhunës në familje në përputhje me masat qeveritare kundër pandemisë COVID-19.

Në mars, Sebahate Morina u vra nga ish-bashkëshorti i saj, Lulzim Sopi, 11 ditë pasi vajza e saj raportoi në polici se nëna e saj po abuzohej fizikisht. Në vitin 2019, Sopi ishte akuzuar për dhunë në familje dhe, përkundër dhunës së vazhdueshme ndaj gruas së tij, Gjykata Themelore e Gjilanit, pas pranimit të fajësisë nga Sopi, ia shqiptoi vetëm një gjobë penale. Një urdhër ndalimi civil kundër Sopotit ishte në fuqi deri tre muaj para vrasjes së raportuar të Morinës. Në mars, Avokati i Popullit lëshoi një raport lidhur me këtë vrasje, duke konstatuar se autoritetet nuk kishin bërë vlerësim të duhur të rrezikut dhe u mungonte koordinimi.

Në gusht, dy burra e lanë trupin e 18 vjeçares Marigona Osmani para një spitali në Ferizaj. Mjekët konfirmuan se Osmani ishte dhunuar dhe abuzuar fizikisht për të paktën dy ditë dhe ishte e vdekur kur u gjet te spitali. Nga pamjet e kamerave të sigurisë së spitalit, Policia e Kosovës i identifikoi Dardan Krivaqën, bashkëshortin e Osmanit, dhe Arbër Sejdiun si të dyshuar dhe të dytë i arrestoi dy ditë më vonë. Raportet e shtypit treguan se policia i kishte akuzuar edhe më parë të dy burrat për shumë vepra të tjera të dhunshme, përfshirë dhunimin, lëndimin trupor dhe tentativën për vrasje. Incidenti shkaktoi protesta mbarëkombëtare kundër mosveprimit të perceptuar të policisë. Që nga shtatori, të dy të dyshuarit ishin në paraburgim në pritje të hetimeve të mëtejme.

Qeveria i licencoi dhe mbështeti 10 OJQ që u ndihmonin fëmijëve dhe grave të mbijetuara të dhunës në familje. Qeveria themeloi një linjë buxhetore për mbështetje financiare të strehimoreve, duke zgjidhur kështu një problem afatgjatë të financimit. OJQ-të dhe strehimoret raportuan se mjetet financiare i merrnin me kohë.

Zyra e Kryeministrit themeloi një komision për njohjen dhe kompensimin e të mbijetuarve të dhunës seksuale gjatë konfliktit. Komisioni ka dhënë pensione për më shumë se 900 gra që nga viti 2018. PSRK-ja e caktoi një prokuror për rastet e dhunës seksuale të kohës së konfliktit.

KOSOVA

Policia e themeloi një njësi për rastet e krimeve të luftës, përfshirë rastet e dhunës seksuale të kohës së konfliktit.

Ngacmimi seksual: Ligji e përkufizon ngacmimin seksual në procedurat civile dhe penale. Neni i kodit penal për ngacmimin seksual parashikon që procedura penale të fillohet me kërkesë të viktimës dhe dënimet me burg lejohen për veprat e ngacmimit seksual ndaj viktimave të cenueshme. Në rastet kur një krim është kryer me përdorimin e një arme, dënimi mund të sillet prej një deri në pesë vjet burg. OJQ-ja Rrjeti i Grave të Kosovës raportoi se zbatimi i ligjeve për ngacmimin seksual u pengua nga procedurat e përcaktuara dobët për parashtrimin e ankesave për ngacmim, dhe nga mungesa e qartësisë në lidhje me atë se cilat organe qeveritare duhet t'i marrin këto ankesa.

Sipas organizatave për të drejtat e gruas, ngacmimi seksual ishte i rëndomtë në vend të punës në sektorin publik e privat dhe në institucionet publike të arsimit të lartë.

Të drejtat riprodhuese: Nuk pati raporte për abortim të detyruar apo sterilizim jovullnetar nga autoritetet qeveritare

Individët e varfër, të marginalizuar e të pashkolluar shpesh kishin qasje të pamjaftueshme në informacione për shëndetin riprodhues. Për ta trajtuar këtë problem, Qeveria dhe Fondi i OKB-së për Popullsinë krijuan kurrikulat për planifikim të familjes për të gjitha nivelet arsimore dhe filluan trajnimin e edukatorëve për zbatimin e saj.

Qeveria kërkon që personat transgjinorë t'i nënshtrohen sterilizimit të detyrueshëm para se ta ndryshojnë shënjesin e gjinisë së tyre (shih Aktet e dhunës, diskriminimi dhe abuzimet e tjera të bazuara në orientim seksual dhe identitet gjinor, më poshtë, për informacione shtesë).

Ligji Kombëtar për Shëndetin Riprodhues e obligon Qeverinë të sigurojë qasje në shërbimet e shëndetit seksual dhe riprodhues për të mbijetuarit e dhunës seksuale, përfshirë të mbijetuarit e dhunës seksuale që lidhet me konfliktin. Kontracesioni urgjent nuk ishte gjithmonë në dispozicion si pjesë e menaxhimit klinik të dhunimit. Ministria e Shëndetësisë i përfshiu barnat për kontracesion urgjent në listën e barnave esenciale për qendrat shëndetësore, por Fondi i OKB-së për Popullsinë raportoi se disa qendra nuk kishin gjithmonë barna në dispozicion. Rrjeti i Grave të Kosovës raportoi se nuk ishte në dijeni për shërbimet e kontracesionit urgjent në vend. Të mbijetuarve iu caktua një “zyrtar mbrojtës i viktimës”, i cili u ndihmoi si në drejtësinë penale, ashtu edhe në proceset e trajtimit mjekësor.

Diskriminimi: Ligji parasheh status dhe të drejta të njëjta për gra dhe burra. Ligji kërkon paga të njëjta për punën e njëjtë. Ligji përcakton që partnerët në martesë dhe bashkësi civile kanë të drejta të barabarta për të poseduar dhe trashëguar pronë, por meshkujt zakonisht e trashëgonin pronën e familjes dhe pasuritë e tjera. Në raste të rralla, të vejat shqiptare, posaçërisht në zonat rurale, rrezikonin ta humbnin kujdestarinë e fëmijëve të vet për shkak të një zakoni familjar i cili kërkonte që fëmijët dhe prona t'i kaloheshin familjes së babait të ndjerë, ndërsa e veja të kthehej në familjen e saj amnore.

KOSOVA

Relativisht pak gra fituan pozita udhëheqëse të nivelit të lartë në biznes, polici apo Qeveri. Rrjeti i Grave të Kosovës raportoi se gratë shpesh u nënshtroheshin praktikave diskriminuese në punësim.

Përzgjedhja e fëmijës bazuar në parapëlqimin gjinor: Raporti djem-vajza në lindje ishte 108 me 100. Qeveria nuk kishte politika për ta trajtuar këtë çekuilibër.

Dhuna dhe diskriminimi sistematik, racor apo etnik

Kushtetuta ndalon diskriminimin në baza racore apo etnike. Kushtetuta lejon miratimin e masave të përkohshme për t'i mbrojtur ose avancuar të drejtat e grupeve të pakicave etnike apo të individëve që vuajnë nga diskriminimi. Raportimet për dhunë dhe diskriminim kundër anëtarëve të grupeve të pakicave etnike vazhduan. Ligji garanton mbrojtje të barabartë, pa diskriminim, në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimit politik ose mendimit tjetër, origjinës kombëtare apo sociale, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike dhe sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose statusit tjetër personal. Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi vendos një sistem gjithëpërfshirës të mbrojtjes nga diskriminimi në vend dhe cakton dy subjekte – Institucionin e Avokatit të Popullit dhe Zyrën për Qeverisje të Mirë pranë Zyrës së Kryeministrit – si organe administrative përgjegjëse për zgjidhjen e rasteve të diskriminimit, promovimin e barazisë dhe monitorimin e zbatimit të masave kundër diskriminimit. Kodi penal përmban dispozita për t'i klasifikuar veprat e tilla si “akte të urrejtjes”, ku raca apo përkatësia etnike është faktor motivues.

Sipas Institucionit të Avokatit të Popullit, edhe pse ekziston një kornizë e mirë ligjore për mbrojtjen e pakicave racore dhe etnike, ka pasur probleme që e pengonin zbatimin e plotë dhe efektiv, përfshirë mungesën e kapaciteteve institucionale. Dhuna shoqërore, si dhe diskriminimi social dhe në punësim, vazhduan kundër serbëve të Kosovës dhe komuniteteve tjera të pakicave etnike.

Gjatë korrikut, Policia e Kosovës raportoi për gjashtë incidente të dhunës shoqërore ose diskriminimit që i synojnë pakicat etnike, përfshirë vendosjen e fotografive të kohës së luftës në banesën e një të kthyeri serb në Gjakovë (shih seksionin 2.e., Statusi dhe trajtimi i personave të zhvendosur brenda vendit), dhe vandalizimin e një kisha ortodokse në Prishtinë. Në maj, Policia e Kosovës e miratoi një *Doracak për trajtimin e krimeve të urrejtjes*, dhe hetimet nga policia të incidenteve që i synonin pakicat etnike rezultuan në disa arrestime. Komuniteti serb i Kosovës shprehu shqetësimin se përgjigjet e Qeverisë nuk ishin adekuate.

OJQ-ja Aktiv raportoi për 48 incidente në gjashtë muajt e parë që e synonin komunitetin serb të Kosovës dhe objektet e Kishës Ortodokse Serbe, përfshirë dëmtimin e pronës, plaçkitjet dhe vjedhjet, sulmet dhe kërcënimet fizike, dhe mbishkrimet ofenduese. Në gusht, platforma për avokim Empirika lëshoi një kumtesë për shtyp përmes së cilës kërkonte hetime të plota të rasteve të pazgjidhura, veçanërisht të atyre që përfshinin sulme fizike kundër serbëve të Kosovës. Mediat në gjuhën serbe rregullisht raportuan për incidente, përfshirë dy sulme në korrik, një kundër një adoleshenti nga shqiptarët e Kosovës në Vushtrri dhe një tjetër kundër një serbi të zhvendosur që e vizitonte pronën e tij në Klinë. Në shtator, Policia e Kosovës i

KOSOVA

arrestoi disa shqiptarë të Kosovës, përfshirë të mitur, të dyshuar për një sulm që synonte një grup të serbëve të Kosovës në Mitrovicë e Jugut.

Ngacmimi i pjesëtarëve serbë të Forcës së Sigurisë së Kosovës nga serbët e tjerë etnikë ishte i zakonshëm, edhe pse zakonisht incidentet ishin të vështira për t'u gjurmuar. Viktimat në shumicën e rasteve nuk i raportuan incidentet në polici nga frika e përshkallëzimit dhe hakmarrjes. Ministria e Mbrojtjes dhe udhëheqja e Forcës së Sigurisë së Kosovës vazhduan të ndërmarrin hapa për t'i mbrojtur pjesëtarët serbë të Kosovës, përfshirë dokumentimin më të mirë të incidenteve, kontrollet e rregullta të mirëqenies nga komandantët dhe përpjekjet për ta përmirësuar reagimin e policisë dhe të Agjencisë Kosovare të Inteligjencës.

Në dhjetor, Gjykata Supreme i anuloi dënimet e Gjykatës Themelore dhe të Gjykatës së Apelit kundër ish-deputetit të Parlamentit Ivan Todosijeviq nën akuzat për nxitje të jotolerancës dhe mohimit të mizorive të kryera kundër civilëve shqiptarë në vitin 1999. Aktvendimi i Gjykatës Supreme e anuloi dënimin e mëparshëm prej dy vjetësh burgim dhe urdhëroi rigjykim. Todosijeviq ishte Ministër i Administrimit të Pushtetit Lokal në vitin 2019 kur e mohoi masakrën e Reçakut, vrasjen e 45 shqiptarëve, gjatë një fjalimi publik.

Qasja në drejtësi për serbët e Kosovës vazhdoi të përmirësohej në sajë të integritit në vitin 2017 të sistemit gjyqësor në katër komunat veriore me shumicë serbe dhe integritit të gjykatësve dhe stafit serb të Kosovës në gjykatat e tjera themelore në vend. Gjyqësori vuante nga mungesa e financimit dhe e mbështetjes për anëtarët e komuniteteve pakicë. Përkthimi i dobët ose i vonuar në procedura gjyqësore, numri i rasteve të pazgjidhura në veri, mosekzekutimi i vendimeve të gjykatave, numri i kufizuar i stafit të pakicave dhe mospërputhja midis përkthimeve të legjislacionit në gjuhën shqipe dhe serbe vazhduan ta pengonin ofrimin e drejtësisë për serbët e Kosovës dhe komunitetet e tjera pakicë.

Pakicat etnike, përfshirë komunitetin serb, rom, ashkali, egjiptian, turk, boshnjak, goran, kroat dhe malazet, vazhduan të përballen me nivele të ndryshme të diskriminimit institucional dhe shoqëror në punësim, arsim, shërbime sociale, përdorim të gjuhës, liri të lëvizjes, të drejtën për t'u kthyer në shtëpitë e tyre (për personat e zhvendosur) dhe të drejta të tjera themelore të përcaktuara me ligj. Komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian shpesh nuk kishte qasje në higjienë themelore, kujdes mjekësor dhe shkollim, dhe vareshin me të madhe nga ndihmat humanitare për mbijetesë.

Zyra e Kryeministrit për Çështje të Komuniteteve dhe Institucioni i Avokatit të Popullit theksuan diskriminimin në punësim në sektorin publik pothuaj në të gjitha institucionet lokale dhe nacionale. Ndonëse ligji obligon që 10 për qind e nëpunësve në nivelin lokal dhe nacional të qeverisë të jenë anëtarë të pakicave etnike, përfaqësimi i tyre mbeti i kufizuar dhe në përgjithësi ishte i kufizuar në pozita të nivelit të ulët. Komunitetet më të vogla, si goranët, romët, ashkalinjtë dhe egjiptianët, ishin të nën-përfaqësuar.

Zyra e Komisionerit për Gjuhët vazhdoi ta monitoronte zbatimin e legjislacionit që u jepte status të barabartë dy gjuhëve zyrtare të vendit, shqipes dhe serbishtes, si dhe gjuhëve të tjera zyrtare në nivel lokal, përfshirë gjuhën boshnjake dhe turke. Komisioneri raportoi se administratat komunale dhe institucionet e qeverisë qendrore mbetën jokonsistente në zbatimin

KOSOVA

e dispozitave të ligjeve kombëtare për gjuhët, gjë që rezultoi në qasje të pabarabartë në shërbime publike, informacion, punësim, drejtësi dhe të drejta të tjera.

Mungesa e përkthimit apo përkthimi i dobët mbeti problem për sa u përket ligjeve të shumta, sinjalistikës në institucionet publike dhe komunikimit në procedurat gjyqësore. Gjykatat shpesh dështuan të ofronin shërbime adekuate të përkthimit dhe interpretimit për të pandehur dhe dëshmitarë të pakicave dhe nuk ofronin përkthim adekuat të statutit dhe dokumenteve gjyqësore siç kërkohet me ligj. Përpjekjet e qeverisë për t'i trajtuar këto probleme mbetën jokonsistente.

Fëmijët

Regjistrimi i lindjeve: Fëmijët e fitojnë shtetësinë nga prindërit e vet apo në bazë të lindjes në vend, përfshirë fëmijët e lindur nga prindërit shtetësi të cilëve nuk dokumentohej. Ata që nuk ishin regjistruar kur ishin lindur ishin kryesisht nga komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian. UNICEF-i tregoi se mungesa e regjistrimit mund të ndikojë negativisht në qasjen e fëmijës në ndihma sociale, posaçërisht për fëmijët e riatdhesuar. Fëmijët e paregjistruar konsideroheshin pa shtetësi.

Shkollimi: Ligji kërkon kushte të barabarta për të gjithë nxënësit dhe njeh të drejtën për shkollim publik në gjuhën amtare për nxënës të pakicave deri në mbarim të shkollës së mesme. Ky ligj nuk u zbatua. Udhëheqësit e komunitetit boshnjak, kroat, goran, malazet, rom dhe turk theksuan mungesën e teksteve shkollore dhe të materialeve të tjera në gjuhën serbe, boshnjake e turke, nganjëherë e përdornin kurrikulën në gjuhën shqipe ose kurrikulën e sponsorizuar nga Serbia ose Turqia për t'i mësuar nxënësit.

Abuzimi i fëmijëve: Kodi Penal nuk e kriminalizon në mënyrë të posaçme abuzimin e fëmijëve, por trajton elemente të ndryshme të abuzimit të fëmijëve, përfshirë sulmin seksual, dhunimin, trafikimin dhe pornografinë e fëmijëve, ndër të tjera. Dënimet sillen prej pesë deri në 20 vjet burg. Nuk dihej shkalla e abuzimit të fëmijëve për shkak të stigmës shoqërore dhe mungesës së të dhënave të besueshme.

UNICEF-i, Institucioni i Avokatit të Popullit, Agjencia e Statistikave dhe ministritë përgjegjëse bashkërisht krijuan një sistem të unifikuar të menaxhimit të të dhënave për ta gjurmuar informacionin që lidhet me fëmijët në sektorin e drejtësisë, arsimit dhe mirëqenies sociale

Në korrik 2019, një djalë nëntë vjeçar nga Fushë Kosova u dhunua dhe u vra. Nëna e djalit e kishte raportuar dhunimin e tij, duke e identifikuar autorin e dyshuar, në polici para vrasjes, por autori i dyshuar u lirua pas marrjes në pyetje dhe nuk u arrestua më kurrë. Gjashtë muaj më vonë, fëmija u gjet i vdekur në Fushë Kosovë. Autori i dyshuar u arrestua më pas për dhunim dhe vrasje të rëndë. I pandehuri u dënua përkohësisht në vitin 2020, me dënimin përfundimtar ende në pritje në gusht. Qeveria ia ndau 20.000 euro (23.000 dollarë) familjes së viktimës për ta ndihmuar në lehtësimin e gjendjes së tyre financiare. Pas gjykimit, policia dhe prokurorët filluan t'i rishikojnë bashkërisht të gjitha procedurat dhe veprimet në rastet e abuzimit të fëmijëve. Hetimet disiplinore filluan kundër dy prokurorëve të përfshirë në këtë rast nën dyshimin se nuk arritën t'i trajtojnë pretendimet për abuzim me kohë dhe në mënyrë

KOSOVA

efikase. Njëri nga prokurorët u ndëshkua nga Këshilli Prokurorial. Rastin e mori një avokat i të drejtave të njeriut dhe kërkoi që zyrtarët të mbaheshin përgjegjës për mosveprim.

Martesa e hershme dhe e detyruar e fëmijëve: Ligji lejon që personat të martohen në moshën 16-vjeçare, me pëlqim të prindërve. Ndonëse nuk ka të dhëna zyrtare për raste të martesës së hershme dhe të detyruar të fëmijëve, ajo ishte praktikë e rëndomtë në komunitetin rom, ashkali, egjiptian, boshnjak dhe goran. Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës dhe UNICEF-it, ndërsa përqindja e përgjithshme e grave të moshës 20 deri 24 vjeçare që martoheshin para moshës 18 vjeçare ishte e ulët, përqindja për gratë në komunitetin rom, ashkali dhe egjiptian ishte tepër e lartë, në një në tri. Sipas një raporti të qeverisë që përqendrohej në komunitetin rom, ashkali dhe egjiptian, rreth 12 për qind e fëmijëve, kryesisht vajza, martoheshin para moshës 15-vjeçare. Nivelet e larta të varfërisë në këto komunitete i kontribuan kësaj përqindjeje.

Shfrytëzimi seksual i fëmijëve: Ligji ndalon posedimin, prodhimin dhe shpërndarjen e pornografisë së fëmijëve. Personat që prodhojnë, përdorin apo përfshijnë fëmijë në krijimin apo prodhimin e pornografisë mund të dënohen prej një deri në 5 vjet burg. Shpërndarja, promovimi, transmetimi, ofrimi apo paraqitja e pornografisë së fëmijëve dënohet prej gjashtë muaj deri në 5 vjet burg. Posedimi ose prokurimi i pornografisë së fëmijëve dënohet me të holla apo me burg deri në tri vjet.

Mosha minimale për marrëdhënie seksuale me pëlqim është 16 vjeç. Dhunimi i të miturës është vepër penale dhe dënohet prej 5 deri në 20 vjet burg. Terre des Homme Kosova raportoi se mekanizmat kombëtarë për identifikimin dhe referimin e fëmijëve që janë të cenusëm nga shfrytëzimi seksual janë joefektivë. Organizata theksoi se fëmijët e transportuar nga Shqipëria për punë në rrugë identifikoheshin në mënyrë joadekuate si viktime të mundshme të trafikimit ose fëmijë në rrezik për trafikim. Komuna e Prishtinës themeloi një task forcë speciale që synonte trajtimin e këtyre çështjeve dhe siguroi mbrojtje dhe shërbime të nevojshme për fëmijët e angazhuar në punën në rrugë.

Rrëmbimet ndërkombëtare të fëmijëve: Kosova nuk është palë e Konventës së Hagës së vitit 1980 për aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijës. Shih *Raportin vjetor mbi rrëmbimin ndërkombëtar prindëror të fëmijëve* të Departamentit të Shtetit në: <https://travel.state.gov/content/travel/en/International-Parental-Child-Abduction/providers/legal-reports-and-data/reported-cases>.

Antisemitizmi

Sipas përfaqësuesve të komunitetit hebraik, në vend jetonin rreth 50 hebrenj. Nuk pati raportime për akte antisemitike.

Trafikimi i personave

Shih *Raportin mbi Trafikimin e Personave* të Departamentit të Shtetit në: <https://www.state.gov/trafficking-in-persons-report/>.

KOSOVA

Personat me aftësi të kufizuara

Kushtetuta dhe ligji ndalojnë diskriminimin e personave me aftësi të kufizuara fizike, ndijore, intelektuale dhe mendore, dhe sigurojnë qasje të barabartë në arsim, punësim dhe shërbime të tjera shtetërore. Qeveria nuk i zbatoi në mënyrë efikase këto dispozita dhe personat me aftësi të kufizuara u përballën me diskriminim dhe nuk kishin qasje në arsim, shërbime shëndetësore, ndërtesa publike dhe transport si të tjerët.

Opsionet arsimore për fëmijët me aftësi të kufizuara ishin të kufizuara. UNICEF-i, përmes partnerit zbatues Handi-Kos, i vlerësoi 30 komuna dhe gjeti që ndërtesat e shkollave fillore dhe të mesme të ulëta kishin pengesa të shumta arkitekturore që e pengonin përfshirjen dhe regjistrimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara fizike në arsimin e rregullt. Për shembull, 56 për qind e shkollave nuk kishin rampa për karroca për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe 74 për qind e tyre nuk kishin tualete të qasshme. Sipas Handi-Kos-it, rreth 38.000 fëmijë me aftësi të kufizuara nuk e kanë vijuar shkollën.

Sipas Handi-Kosit, qasja në shërbimet shëndetësore dhe rehabilituese, përfshirë ndihmën sociale dhe pajisjet ndihmëse për personat me aftësi të kufizuara, mbeti e pamjaftueshme.

Qasja fizike në institucionet publike mbeti e vështirë, edhe pas zbatimit të akteve nënligjore për qasje në ndërtesa dhe mbështetjes administrative. Handi-Kosi raportoi se pajtimi i komunës me një urdhër për qasje në ndërtesat qeveritare mbeti në shifra njëshe. Vetë ndërtesa e parlamentit nuk ishte e qasshme dhe një deputet në karrocë invalidësh duhej të transportohej në sallën e kuvendit nga kolegët. Po kështu, në komunën e Suharekës, personat me karroca invalidësh kishin qasje vetëm në katin përdhes të ndërtesës së komunës, por jo në katet ku ishin zyrat e kryetarit dhe të drejtorëve.

Edhe pse ligji kërkon qasje të barabartë në transport për personat me aftësi të kufizuara, Institucioni i Avokatit të Popullit e publikoi një raport në vitin 2020 duke kritikuar qasjen e pabarabartë në transportin ndërrurban për personat e verbër, pavarësisht kërkesave ligjore. Raporti konstatoi që masat për qasje në transportin publik për vendet e rezervuara, koston dhe zbatimin ishin të pamjaftueshme.

Në qershor, qeveria krijoi një këshill për personat me aftësi të kufizuara si një organ këshillimor qeveritar, me përfaqësues nga ministrinë përkatëse dhe OJQ-të, për ta përmirësuar zbatimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara. Këshilli e mbajti mbledhjen e vet të parë në qershor dhe plani i tij i punës përfshin zbatimin e *Strategjisë Kombëtare 2013-2023*

Aktet e dhunës, diskriminimi dhe abuzimet e tjera të bazuara në orientim seksual dhe identitet gjinor

Kushtetuta dhe ligji ndalojnë diskriminimin e bazuar në orientim seksual dhe identitet gjinor në “sferat publike dhe private të jetës shoqërore, përfshirë jetën politike dhe publike, punësimin, arsimin, shëndetin, ekonominë, përfitimet sociale, sportin, kulturën dhe fusha të tjera”. Kur motivimi për një krim bazohet në gjininë, orientimin seksual ose afinitetin e

KOSOVA

perceptuar të viktimës me personat që janë cak i një armiqësie të tillë, ligji e konsideron motivimin si rrethanë rënduese.

Sipas OJQ-ve për të drejtat e njeriut, komuniteti i lesbikeve, homoseksualëve, biseksualëve, transgjënorëve, pederastëve dhe interseksualëve (LGBTQI+) përballej me diskriminim të hapur në punësim, strehim, përcaktim të shtetësisë dhe qasje në shkollim e kujdes shëndetësor.

OJQ-ja Qendra për Barazi dhe Liri raportoi se presioni shoqëror i bindi shumicën e personave LGBTQI+ që ta fshehin orientimin e tyre seksual ose identitetin gjënor. Qendra gjithashtu i ceku reagimet publike homofobike në rritje në mediat sociale që nga fillimi i zbatimit të masave të qeverisë në tërë vendin kundër pandemisë COVID-19.

Gjatë këtij viti, tri raste të dhunës që kishin në shënjestër LGBTQI+ janë raportuar në Policinë e Kosovës dhe më pas janë referuar në Prokurori. Dy raste u regjistruan si nxitje e urrejtjes, përçarjes dhe jotolerancës të bazuara në bazat fetare, racore ose etnike, dhe një rast u regjistrua si nxitje e kërcënimit. Në maj, një individ i paidentifikuar e kërcënoi me jetë aktivistin e LGBTQI+ Lend Mustafa në sheshin kryesor të Prishtinës. Mustafa raportoi se personi i panjohur e kishte pështyrë dhe kërcënuar për ta vvarë. Edhe pse policia e nisi një hetim, asnjë akuzë nuk ishte ngritur që nga dhjetori.

Policia ishte përfshirëse dhe i pranonte LGBTQI+ dhe komunitetet e tjera pakicë në mesazhet e tyre publike, dhe zyrtarë të lartë të policisë morën pjesë në paradën vjetore të krenarisë. Komuna e Prishtinës krijoi një qendër pranimit në vitin 2020 dhe ndau fonde për ndërtimin e strehimores së parë për personat LGBTQI+ në rrezik gjatë vitit.

Në vitin 2019, Gjykata e Apelit e mbështeti një aktvendim të gjykatës themelore që lejoi ndërrimin e shënjesit të gjinisë në dokumentet e identitetit nga femër në mashkull për një shtetas që jeton jashtë vendit. Gjithsej dy shtetas i kanë ndërruar dokumentet e identitetit pas procedurave të gjata gjyqësore, ndërsa kërkesat e katër shtetasve për ndryshimin e dokumenteve të identitetit nuk janë zgjidhur. Qeveria kërkon që personat transgjënorë t'i nënshtrohen sterilizimit të detyrueshëm para se ta ndryshojnë shënjesin e gjinisë së tyre

Seksioni 7. Të drejtat e punëtorëve

a. Liria e asociimit dhe e drejta për të negociuar kolektivisht

Ligji parashikon të drejtën e punëtorëve për të formuar dhe për t'iu bashkuar sindikatave të pavarura, për të negociuar kolektivisht dhe për të bërë greva. Ligji ndalon diskriminimin antisindikal dhe shkeljen e të drejtave të punëtorit për shkak të aktiviteteve të tij/saj sindikale. Ligji kërkon rikthimin e punëtorëve të larguar nga puna për shkak të veprimtarisë sindikale, përfshirë në shërbimet themelore. Ligji zbatohet njëloj për të gjithë individët që punojnë në sektorin publik dhe privat, përfshirë migrantët e dokumentuar dhe punëtorët vendorë.

Qeveria nuk i zbatoi në mënyrë efektive ligjet e punës, të cilët përfshinin rregullore dhe udhëzime administrative që i rregullojnë marrëdhëniet e punësimit, përfshirë të drejtën e lirisë së asociimit dhe negociimit kolektiv. Sipas Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Kosovës

KOSOVA

(BSPK), burimet, inspektimet dhe masat mbrojtëse nuk ishin adekuate. Dënimet për shkelje nuk ishin në përputhje me dënimet për ligjet që kanë të bëjnë me të drejtat civile. Procedurat administrative dhe gjyqësore ishin të ndërlikuara dhe u nënshtroheshin vonesave të gjata apo ankesave.

Punëdhënësit nuk i respektonin gjithmonë të drejtat e organizatave të punëtorëve për të negociuar kolektivisht, posaçërisht në sektorin privat. BSPK-ja raportoi se shumë punëdhënës të sektorit privat në përgjithësi i shpërfillën ligjet e punës.

BSPK-ja raportoi për vështirësi të vazhdueshme në formimin e sindikatave të reja të pavarura për shkak të ndërhyrjes së punëdhënësve në shoqatat dhe sindikatat e punëtorëve, posaçërisht në sektorin bankar, të ndërtimitarisë dhe hotelarisë. Përfaqësues të këtyre sektorëve i thanë BSPK-së në kushte anonimiteti se disa punëdhënës përdorën kërcënimin për ta penguar formimin e sindikatave. Inspektorati i Punës raportoi se nuk kishte marrë asnjë ankesë zyrtare për diskriminim kundër punëtorëve që u përpoqën t'u bashkohen sindikatave; megjithatë, Inspektorati nuk ishte plotësisht funksional për shkak të mungesës së buxhetit dhe të stafit. Përveç kësaj, punëdhënësit nuk i respektonin gjithmonë të drejtat e organizatave dhe sindikatave të punëtorëve për të negociuar kolektivisht ose për t'u lidhur me sindikatat jashtë organizatës së tyre, posaçërisht në sektorin privat.

b. Ndalimi i punës së dhunshme apo të detyruar

Ligji i ndalon të gjitha format e punës së dhunshme apo të detyruar. Qeveria nuk e zbatoi në mënyrë efektive ligjin, dhe puna e dhunshme, përfshirë punën e detyruar të fëmijëve, ndodhi (shih Seksionin 7.c.). Burimet e Qeverisë, përfshirë masat mbrojtëse, nuk mjaftonin për të siguruar zbatim të ligjit, për t'i identifikuar dhe mbrojtur viktimat, dhe për t'i hetuar pohimet për punë të dhunshme apo të detyruar. Inspektorati i punës raportoi se kishte kryer vetëm hetime të kufizuara për vepra penale të punës së dhunshme. Dënimet, ndonëse ishin në përputhje me dënimet për krime të tjera të rënda, rrallë zbatoheshin.

Shih gjithashtu *Raportin mbi Trafikimin e Personave* të Departamentit të Shtetit në: <https://www.state.gov/trafficking-in-persons-report/>.

c. Ndalimi i punës së fëmijës dhe mosha minimale për punë

Ligji i ndalon të gjitha format e këqija të punës së fëmijës. Mosha minimale për punë është 15 vjet, nëse puna e tillë nuk është e dëmshme për fëmijën apo nuk e pengon atë për ta vijuar mësimin. Mbrojtjet për moshën minimale nuk shtrihen në sektorin joformal. Nëse puna ka të ngjarë ta rrezikojë shëndetin, sigurinë apo moralin e të rinjve, mosha minimale ligjore është 18 vjet.

Ligji i vitit 2020 për mbrojtjen e fëmijës i përcakton standardet kryesore për mbrojtjen e punës së fëmijëve që i bashkon të gjitha dokumentet e tjera ligjore dhe nënligjore në këtë temë. Ai parashikon dënime shtesë për punëdhënësit formalë dhe joformalë të fëmijëve që janë në përputhje me dënimet për krime të ngjashme. Ligji nuk e trajton plotësisht problemin e punës së fëmijëve, pasi ligji nuk i shtrin mbrojtjet për fëmijët që punojnë në ekonominë joformale.

Raportet e Shtetit mbi Praktikën e të Drejtave të Njeriut për vitin 2021
Departamenti i Shtetit i Shteteve të Bashkuara • Zyra për Demokraci, të Drejtat e Njeriut dhe Punë

KOSOVA

Qeveria nuk e zbatoi ligjin në mënyrë efektive. Dënimet rrallë zbatoheshin. Inspektorët menjëherë i njoftonin punëdhënësit kur të miturit shfrytëzoheshin ose gjendeshin të përfshirë në kushte të rrezikshme të punës. Puna e fëmijëve ndodhi kryesisht në sektorin joformal. Që nga maji, OJQ-ja Terres Des Hommes raportoi për 115 të të miturve që punonin në kushte të rrezikshme.

Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve raportoi se fëmijët që punonin në bujqësi hasnin në rreziqe që lidheshin me përdorimin e pajisjeve bujqësore. Koalicioni raportoi se puna e fëmijës në bujqësi vazhdoi si aktivitet tradicional. Qendrat për punë sociale, të drejtuara nga qeveria, raportuan se fëmijët e angazhuar në aktivitete bujqësore ishin kryesisht në sektorin joformal dhe nuk pengoheshin nga vijimi i mësimin.

Fëmijët në zonat urbane shpesh punonin në një sërë punësh joformale në ndërtimtari dhe në rrugë, si shitja e gazetave, cigareve, ushqimit, kartelave të telefonit ose sendeve të tjera të vogla. Disa fëmijë, posaçërisht fëmijët nga pakicat etnike ose nga familjet që marrin ndihmë sociale, iu nënshtruan lypjes së detyruar ose u angazhuan në punë fizike, si transportimi i mallrave dhe mbledhja e gjësendeve në grumbuj të mbeturinave për t'i shitur.

Shih *Konkluzionet mbi format më të këqija të punës së fëmijës* të Departamentit të Punës në: <https://www.dol.gov/agencies/ilab/resources/reports/child-labor/findings/>.

d. Diskriminimi në lidhje me punësimin dhe profesionin

Ligji ndalon diskriminimin në lidhje me punësimin në bazë të racës, fesë, origjinës kombëtare, seksit, përkatësisë etnike, aftësisë së kufizuar, moshës, orientimit seksual, identitetit gjinor, statusit HIV ose AIDS ose përkatësisë politike. Qeveria nuk e zbatoi në mënyrë efektive ligjin dhe dënimet nuk ishin në përputhje me dënimet për krime të ngjashme. Diskriminimi në punësim dhe profesion ndodhi në të gjithë sektorët në bazë të seksit, gjinisë, identitetit gjinor, aftësisë së kufizuar, fesë, përkatësisë politike dhe statusit të pakicës (shih Seksionin 6). Gjatë vitit, BSPK-ja pranoi raporte nga sindikatat dhe individët që pohonin për diskriminim në bazë të anëtarësimin sindikal, moshës dhe statusit familjar. Zyrtarë të BSPK-së dhe të sindikatave theksuan se punësimi, posaçërisht në sektorin publik, shpesh varej nga statusi dhe përkatësia politike e punëtorit. Zyrtarë të sindikatës raportuan për keqtrajtime të tjera, përfshirë ngacmimin seksual, të bazuara në përkatësinë politike partiake. BSPK-ja raportoi raste kur punëdhënësit i diskriminuan femrat gjatë intervistave për punësim dhe i përjashtonin në mënyrë të paligjshme për shkak të shtatzënisë ose për shkak se kërkonin pushim të lehonisë. Institucioni i Avokatit të Popullit raportoi për raste të diskriminimit ndaj nënave të vetme, posaçërisht në lidhje me të drejtat e tyre për pushim të lehonisë, dhe i rekomandoi Inspektoratit të Punës t'i monitoronte këto dukuri. Organizatat për të drejtat e grave raportuan se abuzimi dhe ngacmimi seksual kishte ndodhur në punë, por nuk u raportua për shkak të frikës nga largimi nga puna ose hakmarrja.

e. Kushtet e pranueshme të punës

Ligjet për paga dhe orar të punës: Paga minimale, e caktuar nga qeveria, ishte më e lartë se pragu zyrtar i varfërisë.

Ligji parashikon javën standarde të punës prej 40 orësh, kërkon periudha pushimi, kufizon numrin e orëve të rregullta të punës deri në 12 orë në ditë, kufizon punën jashtë orarit deri në 20 orë në javë dhe 40 orë në muaj, kërkon pagesën shtesë për punën jashtë orarit dhe ndalon punën e tepërt e të detyrueshme jashtë orarit. Ligji parashikon 20 ditë pushim me pagesë në vit për punëtorë dhe 12 muaj pushim pjesërisht të paguar të lehonisë.

Inspektorët e Ministrisë së Punës ishin përgjegjës për zbatimin e të gjitha standardeve të punës, përfshirë ato që kanë të bëjnë me pagat dhe orarin e punës. Qeveria nuk e zbatoi në mënyrë efektive ligjin dhe gjobat nuk ishin në përputhje me gjobat për shkelje të ngjashme. Numri i inspektorëve nuk mjaftonte për t'i parandaluar shkeljet në sektorin formal dhe joformal dhe zbatimi u kufizua edhe më shumë nga pandemia COVID-19. Inspektorët kanë të drejtë të bëjnë inspektime të paparalajmëruara dhe të fillojnë sanksione; megjithatë, inspektorati nuk ishte plotësisht funksional për shkak të mungesës së buxhetit dhe stafit.

Sipas BSPK-së, punëdhënësit dështonin t'i respektonin standardet zyrtare të punës të cilat siguronin standarde të barabarta të mbrojtjes për punëtorët e sektorit publik dhe privat. BSPK-ja raportoi për mungesë të mbikëqyrjes qeveritare dhe të zbatimit të ligjit, posaçërisht lidhur me javën standarde të punës dhe punën e detyrueshme e të papaguar jashtë orarit. Shumë individë punonin me orar të gjatë në sektorin privat, gjoja "sipas dëshirës së tyre", pa kontratë pune, pa pagesë të rregullt apo pa kontribute pensionale. BSPK-ja raportoi se punëdhënësit i përjashtonin punëtorët pa arsye në kundërshtim me ligjin dhe refuzonin t'i respektonin festat e punëtorëve.

Siguria dhe shëndeti në punë: Ligji përcakton standarde të duhura të shëndetit dhe sigurisë për vendet e punës dhe i rregullon të gjitha industritë në vend. Përgjegjësia për identifikimin e vendeve të pasigurta të punës u takon punëdhënësve individualë, ndërsa shërbimet që do të siguronin kushte të sigurta pune u takojnë ekspertëve të sigurisë dhe shëndetit në punë, e jo punëtorëve.

Të njëjtit inspektorë, përgjegjës për ligjet e pagave dhe orarit të punës, kishin gjithashtu autoritet mbi ligjet e sigurisë dhe shëndetit në punë. Qeveria nuk i zbatoi në mënyrë efektive ligjet për sigurinë dhe shëndetin në punë, dhe dënimet për shkeljet nuk ishin në përputhje me ato të ligjeve të ngjashme.

Ligji nuk u lejon punëtorëve të largohen nga një situatë e rrezikshme e punës pa e rrezikuar punësimin e tyre. Sipas Ministrisë së Punës, marrëveshjet joformale punëdhënës-punonjës mund të adresojnë kur dhe nëse punëtorët mund të largohen nga puna për shkak të situatave të rrezikshme të punës, por qeveria nuk i ndoqi këto marrëveshje. Nëntë punëtorë vdiqën për shkak të kushteve joadekuate ose të pasigurta të punës gjatë vitit. Sipas ekspertëve, shkeljet e standardit të pagës, të punës jashtë orarit, të shëndetit dhe sigurisë në punë ishin njëllor për

KOSOVA

burra dhe për gra, si dhe për punëtorët e huaj migrantë, posaçërisht për ata që ballafaqoheshin me kushte të rrezikshme apo eksploatuese të punës, si në ndërtimtari dhe bujqësi.

Spektori joformal: Nuk ka statistika të besueshme zyrtare për ekonominë joformale, por një raport i BE-së, i tetorit 2020, vlerësoi se tregu joformal dhe tregu i zi përbënin 32 për qind të PBB-së. Punëtorët në sektorin joformal nuk mbulohehin nga të gjitha ligjet për paga, për orar të punës dhe për sigurinë dhe shëndetin në punë. Shoqata e Sindikatave të Punës raportoi për mungesë të zbatimit nga gjyqësori, veçanërisht në sektorin joformal, duke cituar kufizime të burimeve dhe të kapaciteteve brenda Inspektoratit të Punës.